



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 27 KORRIK 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 27. JULA 2010. GODINE**

**KORRIK – JULI
2010**

E martë, më 27 korrik 2010, ora 10:00

Drejton seancën: kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kemi numrin e nevojshëm për të filluar debatin.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe të nenit 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

E kemi një pikë shtesë të rendit të ditës dhe pa kuorum nuk mund të vendosim, e lëmë për më vonë.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizimin e Postë – Telekomit të Kosovës

Qeveria e Republikës së Kosovës ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur për miratim Strategjinë dhe vendimin për privatizimin e Postë –Telekomit të Kosovës. Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion e ka shqyrtuar Propozimin e Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizimin e Postë – Telekomit të Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar të hapet debat lidhur me këtë çështje.

Ftoj kryeministrin e Qeverisë, zotin Thaçi që ta prezantojë Projekt-vendimin ose Propozimin e Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Qytetarë të Kosovës,

Sot po shqyrtojmë Projekt-Strategjinë për vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizimin e 75% të aksioneve të ndërmarrjes publike Posta dhe Telekomit të Kosovës.

Fillimisht, dëshiroj të sqaroj para jush se ky vendim është marrë në përputhje të plotë me politikat sektoriale të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për sektorin e Telekomit, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, si dhe pas një analize të thellë gjithëpërfshirëse të PTK-së dhe tregut të bërë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës nga Komisioni ndërministror, i formuar për shqyrtimin e opsioneve për pjesëmarrje të sektorit privat në PTK dhe njësitë tjera varëse të këtij komisioni.

Ky vendim është marrë edhe në konsultim dhe këshilla të të gjitha autoriteteve ndihmuese, këshilluese, ndërkombëtare në Republikën e Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një ambient të sigurt dhe kreativ për investime, ka dëshmuar dhe ka garantuar edhe në të ardhmen transparencë maksimale, ekonomi konkurrense dhe të lirë.

Ne do të zhvillojmë shtetin e Kosovës sipas standardeve të botës së lirë. Duhet të shkëputemi një herë e përgjithmonë nga nostalgjia e së kaluarës, ekonomisë së planifikuar, centraliste dhe prapambetjes. Të shikojmë kah e ardhmja, kah ekonomia e lirë e tregut. Duhet ta largojmë ndikimin ngulfatës, me reflektim ngulfatës të politikës, siç ka ndodh në 11 vitet e kaluara të qeverisë apo shtetit në ekonomi. Ta zhvillojmë kreativitetin e sektorit privat, siç bën në gjithë bota demokratike.

Privatizimi i PTK-së është tjetër reformë ekonomike dhe jo shitje e kapitalit. Privatizimi i PTK-së është një mënyrë transfer kapitali nacional dhe do të jetë në shërbim të zhvillimit të projekteve zhvillimore nacionale jetike për qytetarë dhe shtetin e Kosovës.

Kosova, si shtet i ri, sot më shumë se kurdoherë ka nevojë për investime të huaja për të siguruar zhvillim ekonomik, krijimin e një infrastrukture moderne, hapjen e vendeve të reja të punës dhe implementimin e perspektivës evropiane perëndimore.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur që të hapë mundësitë për investime dhe futje të kapitalit privat në disa nga sektorët më rëndësi për zhvillimin e vendit.

Privatizimi i PTK-së është pjesë e reformave të thella të ndërmarrjeve publike, të cilat Qeveria e Kosovës është përkushtuar se do t'i bëjë deri në fund, të cilat reforma janë në përputhje të plotë me marrëveshjen e Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me aspiratat evropiane perëndimore të Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës është e vendosur në krijimin e një shteti me vlera të larta demokratike, të bazuara në treg të lirë dhe konkurrueshmëri në të gjitha sferat e ekonomisë dhe sektori i Telekomunikacionit do të jetë model i mirë në këtë drejtim.

Aftësia e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të tërhequr investime afatgjate, si në rastin e koncesionimit të suksesshëm të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, fillimit të punimeve të Projektit të autostradës Vërmicë – Prizren – Prishtinë – Merdare është vlerësuar si një e arritur e jashtëzakonshme dhe është tregues i stabilitetit shtetëror dhe mirë qeverisës në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Prandaj, futja edhe e një investitori me emër dhe përvojë në fushën e Telekomit do të jetë një ndihmesë e madhe për zhvillimin e sektorit të Telekomit, por do të jetë edhe një vepër e mirë për investime të tjera që do të vinë dhe po vinë vazhdimisht në Republikën e Kosovës.

Sivjet, nga parametra që kemi, shteti i Kosovës do të ketë investime më të fuqishme ndërkombëtare në rajonin, pra në Ballkanin Perëndimor. Kosova do të ketë, për nga pjesëmarrja e investorëve të huaj, do të jetë e para në rajon.

Kosova ka potencial për zhvillim të mëtutjeshëm të tregut të Telekomit dhe rritje të nivelit penetrimit, i cili është më i ulëti në rajon dhe si i tillë është treg mjaft atraktiv për kompani me përvojë në fushën e Telekomit.

Zonja dhe zotërinj,

Deri më tani kemi kompani të interesuara nga i gjithë globi, mund të themi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendet evropiane, Kina, India e tjerë.

Me privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së, ne liberalizojmë plotësisht tregun e Telekomit në Kosovës, krijojmë një bilanc në treg dhe ju garantojmë qytetarëve rritje të konkurrencës, e cila domosdoshmërisht sjell shërbime më të mira, më cilësore dhe çmime më të lira për qytetarët e Kosovës.

Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, institucionet e saj nuk po bëjnë as më tepër e as më shumë seç ka bërë bota demokratike, seç ka treguar përvoja e mirë e gjitha vendeve të Evropës Juglindore në këtë tranzicion 20 vjeçar. Kosova është e fundit në Evropën Juglindore që i hyn këtij procesi të vonuar e me pasoja ekonomike.

Qeveria e Republikës së Kosovës prandaj konsideron se tani është koha më adekuate për futjen e kapitalit privat në PTK.

Qeveria e Republikës së Kosovës garanton se pavarësisht se kush do të jetë fitues, e fituesin do ta përcaktojë çmimi më i lartë dhe jo Qeveria, se gjithë punëtorët në PTK, në Postë - Telekom do të vazhdojnë të punojnë për më së paku 4 vitet e ardhshme.

Hapja e PTK-së për investues serioz ndërkombëtarë është duke u bërë në kohën e duhur. Çdo vonesë në këtë aspekt mund të ndikojë në drejtimin e investimeve të investitorëve serioz për në sektorë të tjerë.

Studimet e bëra për funksionimin e tregjeve të Telekomit kanë treguar se kompanitë e telekomunikacionit funksionojnë më mirë kur e kanë të inkorporuar kapitalin privat brenda tyre dhe kjo praktikë është ndjekur në po thuaj se të gjitha vendet perëndimore, po ashtu edhe në vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor, të gjithë Evropës Juglindore, gjithashtu.

Deputetë të nderuar,

Ju kenë pasur para jush një dokument të gjerë, ku është analizuar strategjia dhe opsionet për pjesëmarrje të sektorit privat në PTK. Sot jam këtu në mesin tuaj, së bashku me ministrat përkatës, Qeverinë për të dhënë sqarime tjera shtesë, për të inkorporuar vërejtjet dhe sugjerimet tuaja shtesë dhe të gjitha sugjerimet, këshillat do të jenë të mirëpritura dhe do të inkorporohen në dokumentin përfundimtar.

Ky dokument është përgatitur pas një numër analizash e shqyrtimesh të mirëfillta, të bëra nga Këshilli Ndërmnistror i Transaksionit dhe pas konsultimeve të palëve të përfshira në proces.

Nga analizat e bëra kemi ardhur në përfundim se vendimi më i mirë që është në interes të qytetarëve të Kosovës është ofrimi për tenderim dhe shitje së paku 75% të aksioneve të Postës dhe Telekomit të Kosovës, ndërsa dua të potencoj këtu se ka pasur edhe ide e këshilla që të shkohet edhe në shitje të mëtutjeshme dhe të arrihet deri në 90%, sipas përvojave të disa vendeve të Evropës Juglindore. Por, vendosmëria jonë ka qenë që së paku 25% të mbeten si asete të shtetit të Kosovës, të qytetarëve të Kosovës.

Ne, si Qeveri e Kosovës, do të garantojmë që ky proces do të jetë plotësisht i lirë, i hapur, transparent në çdo fazë të tij dhe në pajtueshmëri të plotë me standardet më të larta ndërkombëtare për transaksionet e tilla.

Interesimi i madh i investitorëve në konferencën e organizuar për PTK-në nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në mars të këtij viti, është edhe një tregues për stabilitetin shtetëror që ofron Kosova, për investime të mëdha që vinë nga jashtë dhe për atraktivitetin e kësaj kompanie.

Posta dhe Telekom i Kosovës do të privatizohet, por ne si Qeveri e Kosovës i kemi propozuar Kuvendit të Kosovës që një pjesë të aksionit të kësaj ta mbaj sërish në dispozicionin tonë, që e përmendëm.

Pra, qytetarë e Kosovës janë pjesëmarrës me 25% të aksioneve në këtë kompani. Me investime që do të sillen nga sektori privat në vitet në vijim, shpresojmë se vlera e aksioneve të mbajtura do të rritet në vijimësi. Po ashtu, kemi propozuar që Njësia e biznesit, Posta si një resor i rëndësishë strategjike për shtetin e Kosovës, t'i mbetet në pronësi shtetit të Kosovës pas ndarjes së saj.

Kjo do të mundësojë që postat e Kosovës të jenë pronë e qytetarëve të Kosovës, të cilët do të kenë të garantuar shërbimin postar universal gjithnjë.

Posta dhe Telekom i Kosovës në dekadën e fundit ka qenë një punëdhënës mjaft atraktiv për qytetarët e Kosovës.

Si e tillë, Posta ka staf profesional shumë të përgatitur, të përbërë nga inxhinierë, ekonomistë, menaxher, juristë, profesionistë të tjerë të lëmive të ndryshme, të cilët janë një aset i çmuar për PTK-në dhe Kosovën.

Ne, si Qeveri e Republikës së Kosovës, jemi të përkushtuar që punëtorët e PTK-së në asnjë rrethanë të mos dëmtohen nga ky proces dhe për këtë e kanë garancinë e plotë edhe timin, edhe të Qeverisë.

PTK, si kompani me kapital privat, do të vazhdojë të jetë një prej punëdhënësve më shumë atraktiv në Kosovë. Me privatizimin e PTK-së do të ndalen dukuritë e këqija, do të ndalet korrupsioni, do të ndalen shumë e shumë fenomene negative që kanë ndodhur në ndërmarrjet publike në këto 11 vitet e fundit në Kosovë.

Më lejoni që edhe një herë të nderuar deputetë, t'i garantoj gjithë investitorët potencial në këtë sektor, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që i gjithë procesi i pjesëmarrjes së sektorit privat në PTK do të jetë fer, transparent, i hapur dhe në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë, para jush kemi ofruar një dokument, Projekt – Strategjinë, e cila është shkruar në mënyrë mjaft analitike, aty është analizuar kompania dhe tregu dhe janë dhënë arsyet për zgjidhjen e ofruar.

Gjithashtu, të nderuar deputetë, për transparencën që do të tregohet, do të vazhdohet ashtu siç ka ndodhur edhe me koncesionimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, ku çdo qytetar i Kosovës dhe e gjithë bota do të ketë mundësinë në mënyrë më transparente të mundshme të përcjell shpalljen e fituesi, i cili do të përcaktohet nga çmimi, nga ofertuesi, jo nga Qeveria dhe kjo do të bëhet drejtpërdrejt përmes të gjitha televizioneve tona live.

Miratimi i këtij vendimi pra, të nderuar deputetë, për transaksion, ashtu siç kërkohet me ligjet në fuqi, duhet të merret nga ana e juaj. Ne jemi të bindur se ky vendim shkon në të mirë të qytetarëve të Kosovës dhe është një vendim që do t'i shërbejë edhe kompanisë për zhvillim dhe modernizim të mëtutjeshëm.

Prandaj, kërkoj miratimin e këtij vendimi nga ana e juaj. Falënderoj të gjithë ekspertët, këshilltarët, falënderoj të gjithë njerëzit që i kanë kontribuar këtij debati analitik me opinione të ndryshme për të ardhur te propozimi më i drejtë i mundshëm për privatizimin e PTK-së, qofshin ata vendorë apo ndërkombëtarë.

Prandaj, privatizimi i PTK-së dhe shfrytëzimi i të hyrave që do të vilen nga ky transaksion, do të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës.

Ndërsa, futja e një investitori strategjik në sektorin e Telekomit të Kosovës do të jetë edhe hap tjetër, i cili tregon stabilitetin e shtetit të Kosovës.

Edhe një herë e ritheksoj, të nderuar deputetë, sot jam këtu së bashku edhe me ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Kabinetin qeveritar, që t'i marrim opinionet tuaja, këshillat tuaja, sugjerimet tuaja, vërejtjet tuaja, të inkorporohen në dokumentin përfundimtar dhe të vazhdojmë me procesin dhe agjendën prioritare që e kemi pastaj edhe me privatizimin e Distribuimit të KEK-ut dhe fillimin e projektit madhor energjetik "Kosova e Re". Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

E dëgjuat ekspozenë e kryeministrit.

Sipas radhës, janë grupet parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të respektuar të dashur kolegë deputetë,

Ne, si Grup Parlamentar, e kemi realizuar me shumë vëmendje strategjinë e propozuar nga Qeveria dhe natyrisht që, në parim, jemi gjithsesi për procesin e privatizimit, sepse kjo është logjike kohe, logjike e rrethanave të krijuara dhe natyrisht që si parim dhe si veprim e mbështesim, por jemi për një kujdes të shtuar. Dhe, ky kujdes i shtuar, që është diskutuar gjithsesi në Grup Parlamentar, kërkon që ne të jemi me sqarime përplotësuese, duke mos caktuar kohën se kur, ajo mund të bëhet sot ndërkohë apo në një afat të caktuar, por gjithsesi sot mund të fillohen debatet dhe diskutimet dhe pastaj që të jemi më të sqaruar përfundimisht edhe më mirë, ne kërkojmë këtë sqarim, sepse në fakt jemi të ndërgjegjshëm se logjika e tregut të lirë e përcakton çmimin dhe nuk duam të hymë në ato gjëra, por gjithsesi një shqetësim jo i paktë të bie mbi një term që, besoj, i ka shqetësuar të gjithë ata që i marrin vesh këto gjëra, "aksionar minor" dhe gjëra të tjera që kemi nevojë për t'u sqaruar, ne kërkoj një sqarim përplotësues në mënyrë që pastaj të vendosim më me zemër, që thuhet, më logjikshëm dhe më arsyeshem. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri, e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka analizuar këtë strategji dhe jemi shumë të vetëdijshëm që jemi para një vendimi ose së paku para debatit jashtëzakonisht të rëndësishëm së veçantë, jo për vetëm PTK-në, si të tillë, por edhe pse jo, në një formë edhe për qytetarët e Kosovës. Ne, edhe si grup parlamentar, normalisht, edhe si parti jemi për ekonomi të lirë të tregut, jemi për privatizim. Por, po ashtu, gjatë debateve që i kemi pasur në Grupin Parlamentar të LDK-së, konsiderojmë që ka hapësirë, gjegjësisht ka nevojë që të sqarohen edhe shumë çështje, posaçërisht rreth modaliteteve të ndryshme që parashihen në këtë strategji, po pse

jo edhe më vonë, edhe çështjes së investimit nga ky fond i mjeteve që do të dalë. Thënë, thjeshtë, nuk do të duhej të vepronim nën presion të kohës në mënyrë që të dalim prej këtu pa i diskutuar, pa i diskutuar, pa i sqaruar të gjitha ato që janë të domosdoshme, në mënyrë që ky proces, si i tillë, të shkojë ashtu siç duhet dhe mos të lë asnjë hapësirë, asnjë mjegulli rreth fatit dhe, më mirë të themi, rreth procesit të këtij privatizimi, që mund të ndodhë tash, mund të ndodhë pa paragjykuar. Por, po ju them edhe një herë që ne konsiderojmë, afërsisht dëgjova edhe zotin kryetar të grupit parlamentar të partisë tjetër, po e them këtë, që kemi nevojë ende dhe këto do të dalin, besoj, gjatë debateve dhe diskutimit që do t'i bëjnë edhe kolegët e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, sepse konsiderojmë që si proces është i nevojshëm, por po ashtu është e nevojshme dhe ka nevojë për shumë sqarime të tjera gjatë ditës së sotme, por pa paragjykuar, po them edhe njëherë, nën presionin kohë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën. Regjia, e bëni evidencimin e deputetëve në sallë.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër,

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Ky është një projekt i Qeverisë, Qeveria ka sjellë dhe po shihet që Qeveria nuk i ka deputetët për ta votuar. Realisht, po e këqyrim kryeministër, po si ke, po më duket. Qeveria që nuk i ka deputetët për ta votuar një propozim të vetin, një projekt të vetin ai projekt nuk ka legjitimitet as edhe demokratik. Në fund të fundit, ne e kemi mësuar demokracinë, jemi duke e mësuar demokraci që një kohë të gjatë. Krejt bota u çua për të na mësuar demokracinë. Njerëzit nuk po e donë këtë projekt ose nuk po e donë këtë Qeveri ta implementojë këtë projekt, po njëra është këtu. Po, po shihet qartë që përfaqësuesit e popullit nuk po e donë këtë projekt, e përfaqësuesit e popullit jeni ju, ne jemi, nuk janë këta, këta janë ... ynë, pronari nuk është Qeveria, populli është pronari, ju.

Duhet t'i përmend disa çështje që i kam dëgjua, shembull ta marrim tash, kryeministri tha duam t'i shesim së paku 75% të aseteve, më vonë tha duam t'i mbajmë së paku 25% të aseteve. Kryeministër, këto janë ndryshe, nuk e di gjithkush matematikën, por ndryshe janë, kundra janë, kam dëgjuar mirë, ka transkript. Domethënë, kryeministri nuk po di çka do të mbajë. Po, unë po ju kallëzoj çka shkruan në dokumente. Kërkohet në mbledhjen e Qeverisë, do të thotë, që është mbajë më 16.6.2010, është kërkuar që të ofrojmë tenderim me 75% të aseteve, po 75% të çkafit, cilat janë asetet. Nëse Qeveria e Kosovës, qysh del në dokument, do ta shes Valën dhe deri diku Telefoninë fikëse, e ta mbajë Shërbimin postar, domethënë Qeveria e Kosovës do t'i shesë ato që krijojnë profit e t'i mbajë ato që duhet të subvencionohen menjëherë sa po të shitet, se krijojnë humbje, e pa postë nuk bën, shembull ta marrim, ne nuk mund të funksionojmë pa postë, a mundet Kosova pa postë, të mos kush t'i bie letër në shtëpi, domethënë duhet të mbahen ato që humbin, e duhet të shiten ato që fitojnë.

Tjetër, thuhet që..., Ministria e Financave na jep këtë informacion, thotë: Ka indikacione se në vitin 2009 pjesëmarrja në treg e TK është zvogëluar dhe pjesëmarrja në treg e Ipkos është rritur. Shihni. Ministria e Financave i mbledh taksat, në bazë të komunikacionit paguhen taksat dhe Ministria e Financave e ka aq lehtë t'i dijë saktë shifrat, që është e pamundshme edhe dikush që nuk ka qenë kurrë në Ministri të Financave, mundet t'i dijë këto shifra saktë, por Ministria e Financave na thotë neve - ka indikacione, nuk na jep të qarta shifrat. Përderisa menaxhmenti thotë se u rritë profiti, Ministria e Financave thotë - ka rënë profiti.

Edhe tash po ju them unë kështu disa çështje. Kur ne e privatizojmë ndërmarrjen më fitimprurëse publike të Kosovës, duhet menduar për 10 ose 20 vjet, jo për vitin e ardhshëm. Çka domethënë të mendojmë për 10 ose 20 vjet? Të mendojmë për 10 vitet e ardhshme sa i sjell profit PTK-ja Kosovës, një miliard, 500 milionë, 600 milionë, 700 milionë, s'është me rëndësi. Ose të projektohet ai profit dhe në bazë të atij projektimi të dimë çka po bëjmë kur ta shesim 500 milionë ose 300 milionë, a po humbim apo po fitojmë. Prapë po them, për 10 vjet, nuk llogaritet për vitin e ardhshëm.

Edhe tash po ju kallëzoj, ministri i Financave, për shembull, e di matematikën, nëse e merr një kalkulator të thjeshtë, e kalkulon profitin e vitit të kaluar dhe e projekton me 10% zbritje për çdo vjet, prej sot e deri në vitin 2020, i del që më 10% zbritje PTK-ja mund t'i sjellë Kosovës 800 milionë euro të hyra për 10 vjet. Nëse me 20% zbritje e bën për çdo vjet, që është e pamundshme me 20% zbritje, i sjell diku 500 milionë. Domethënë, kalkulimet janë goxha, goxha, goxha të çuditshme.

Tash po kthehem te esenca, e majta dhe e djathta, e përmendi kryeministri. Po e përmend një farë filozofi anglez, ka vdekur ai, ka thënë njëherë kështu: (historia nuk m'u ka përzier, kryeministër, dëgjomë pak, se unë ty të dëgjova). "Historia gjithkund tregon se kur partitë ose politikanët e majtë sillen në kontakt me realitetin, duke i marrë zyrat politike, ata fillojnë të harrojnë utopianizmin doktrinar të vetin dhe lëvizin në të djathtë krejt dhe krejt çka bëjnë, shkaktojnë konfuzion në terminologjinë politike, kurrëgjë tjetër, veç konfuzion kush është i djathtë e kush është i majtë".

Shitja e aseteve nacionale nuk ka të bëjë me të djathtën a me të majtën, ka të bëjë me 800 milionë ose me 500 milionë ose me 300 milionë, sa fitojmë ne, ne jemi populli, ne duam profit, ne nuk duam të majte a të djathtë, kurrfarë nuk duam, vetëm duam profit. Nëse dikush më thotë mua që është më mirë t'i shesim 300 milionë se t'i fitojmë 800 milionë për 10 vjet, le të vjen le të ma shpjegojë, qoftë ai edhe prej hëne.

Në fund të fundit, edhe një herë po them, mos sillni konfuzion, veç sillna shifrat sa fitojmë nëse i mbajmë, sa fitojmë nëse i shesim dhe, në fund të fundit, edhe një herë po e përsëris të parën që e thashë, është projekt i Qeverisë dhe Qeveria duhet ta votojë, jo opozita, as mos pritni që opozita i del "për" këtij projekti, përpos që nuk është i mirë. Nëse pozita nuk mund ta votojë, le ta rishikojë strategjinë e vet, le ta rishikojë Qeverinë e vet, le t'i rishikojë njerëzit e vet dhe ta rishikojë se a ka mbështetje popullore kjo Qeveri për ta votuar një projekt kësi soji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

AKR-ja, nuk është.

(Reagim nga salla)

Mirë, faleminderit shumë, e respektoj edhe këtë. Në emër të LDD-së, pra, foli Ardiani. Në emër të Grupit Parlamentar "7", deputeti Xhezair Murati e ka kërkuar fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsjedniče!

Dozvolite da pozdravim premijera, zamenika, ministre, kolege, goste!

Mis smo danas načeli jednu, kako se kaže u politici, top temu koja je dugo predmet interesovanja javnosti Kosova i tačno je ono što je i premijer u uvodnoj reči rekao, da smo mi jedni od poslednjih koji počinjemo ovaj proces privatizacije. To nije ni čudo s obzirom na to da je naša država mlada, ali ja ću podržati razmišljanja mojih kolega, koji su do sada govorili. Zaista ovde

nije bilo reči niti o visini vrednosti prodaje, niti je bilo reči o vremenu za koje će biti ta..., koliko će trajati ta prodaja. Svakako je ono što su kolege rekly, transparentnost potrebna i, recimo, gde će Vlada sredstva od prodaje PTK ulagati, koja će to biti prioriteti i tako dalje, tako da činjenica je da se privatizacija državnih firmi poput, recimo pošte, železnice, ne znam Aerodroma i tako dalje, vrši uglavnom u zemljama u tranzicijama, u ekonomski slabijim zemljama, ali nema svugde prodaje i u jakim ekonomskim zemljama nego, naprotiv, kupovine takvih objekata.

Mi se pridružujemo nekim parlamentarnim grupama koje su do sada govorile da ćemo svakako da prihvatimo ovaj proces početka debate o privatizaciji. Znači, početak razgovora, debate o privatizaciji i normalno da ćemo biti deo te debate dok bude ona trajala. Znači, ali uz to da je potrebno, što su rekli i kolege Buja i kolega Beqiri, da u vremenu koja je pred nama, dobijamo štoviše informacija kako bi smo znali mnogo više podataka kako bi smo se prema njima odredili.

U svakom slučaju, ovaj proces razgovora i debate i o prodaji PTK-a prihvatamo, naravno uz to da je ovo jedan proces koji će potrajati. Nas čudi nedovoljno prisustvo poslanika, pogotovu iz vladajuće koalicije, kojoj i sami pripadamo, ali kažem, evo da zaključim moju diskusiju, da mi prihvatamo početak razgovora o privatizaciji PTK. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Mursel Halili e ka kërkuar fjalën.

MURSELJ HALJILJI: Hvala, gospodine predsedniče!

Gospodine predsedniče Vlade,

Zameniće,

Gospodo ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa SLS je ozbiljno razmatrala ovaj dokumenat, znači strategiju za privatizaciju PTK. Smatramo da ima dosta podataka o ovom dokumentu i da je sveobuhvatan. Međutim, kao Parlamentarna grupa mi smo fokusirali neka pitanja, ja bih želeo da ih iznesem ovde, a to su pre svega pitanja vezana za zaštitu zaposlenih, zatim menađiranje mogućeg fonda koji bi se dobio od privatizacije PTK. Takođe, pitanje postojanja zakonske regulative za sprovođenje postupka privatizacije, tu su i metodi, vremenski okviri i neka načela koja su u strategiji iznesena.

Međutim, mi smatramo kao Parlamentarna grupa da nam treba još pojašnjena oko nekih pitanja i naš stav, znači stav SLS-a povodom određivanja i prihvatanja ili neprihvatanja odluke o privatizaciji PTK-a delom će zavisiti od rezultata debate i razjašnjenja nekih značajnih pitanja koja će ići u prilog zaštite svih.

Mis smo u načelu za privatizaciju, jer je liberalizacija i pokreti koji su zahvatili celu Evropu i ovaj deo Evrope, takođe, međutim kažem vam da ćemo mi svoj stav i opredelenje prema ovoj strategiji iskristalisati nakon završetka debate u kojoj ćemo isto tako uzeti učešće. Hvala još jednom!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Para se t'ia jap fjalën përfaqësuesit të Grupit Parlamentar për Integritim, po i njoftoj dy kryetarët e grupeve më të mëdha të koalicionit, se ju mungojnë mbi 22 deputetë. Ne mund të vazhdojmë debatin, por deputetë për të votuar nuk ka. Prandaj, është mirë të angazhoni administratën e juaj që deputetët të vinë në seancë. Tani ia jep fjalën deputetes Vezira Emrush, në emër të Grupit Parlamentar për Integritim.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala na datu reč!

Danas hoću da dam doznajanja, jako mi je žao što je prisutnost poslanika jako mala za jedno jako vitalno pitanje, kada je u pitanju nacionalna imovina Kosova i kada su u pitanju prava građana.

Posebno apelujem kada je u pitanju ovaj izveštaj na međuministarsku komisiju, koja je sačinjena od strane Vlade, na ime odluke Vlade i Pravilnika o usvajanju strategije za privatizaciju PTK. Zašto kažem na ministre? Vidimo da su u komisiji gospoda ministri i meni mi je žao što moram danas da kažem da ovaj izveštaj koji imamo ispred sebe, ima opis situacije Telekomunikacije na Kosovu. Znamo da je PTK-a u vlasništvu države i da je sada transformacija ili kako nam je danas premijer pojasnio, velika ekonomska reforma. Međutim, moram da kažem da od ove ekonomske reforme nema ni „e“. Zašto ovo kažem? Zato što ovaj izveštaj danas ne sadrži analizu, početnu stvar, analizu. Ne sadrži, samo ima opis pošte koliko ima, nemamo broj. Kaže da ima veliki broj radnika, koji broj radnika, vidimo da je profitabilna organizacija, koja 120 miliona godišnje zarađuje. Vidimo da nema potrebe za privatizaciju i spin off-a, vidimo da je zainteresovano dosta tržište svetsko, Međunarodna banka i normalno Svetska banka, Međunarodni Monetarni Fond, ali šta je sa situacijom koja je ovde. Ja moram da kažem da nijedan kriterij za ocenu ponude nije ispunjen. Nema, prvo, biznis plan sa socijalnim programom i finansijsku ponudu, koja se sastoji od kupoprodajne cene, nema početnu cenu, od investicionog programa nema predviđena ulaganja. Znači, imamo samo procenat 75, 25 aseti države i aseti koji će se prodati.

Znači, tenderska procedura je opisana kako će dalje biti kao i uvek, kao što je bilo sa Aerodromom između Vlade i najboljeg odabirača tendera, nije otvoren, znači da je ovo kršenje Zakona o privatizaciji. Posebno apelujem na gospodina Rašića, ministra u međuministarskoj komisiji, da obrati pažnju gde nisu uopšte data analiza i struktura radnika PTK-a, gde pravilno i zna i zajednica nas ostalih, iz srpske zajednice, gube pravo radnici koji su bili radnici do 99. godine, gde nisu opisani jednom rečenicom ovde. Gubi se pravo radnika i sadašnjih zaposlenih, i bivših, zato što je otuđivanje imovine.

Jedno što mogu da kažem i što ne može da ne dira niti Vlada, niti bilo ko ovde, molim da pročitate koje je investitor uslove, kako investitor sebe zaštitio. Regulativna i zakonska pitanja koja je investitor postavio Vladi i gde kaže tačka, ovo čitam iz izveštaja, čitam iz izveštaja, kaže: Nejasan status, znači u izveštaju, Vlada saglasna da nejasan status društvene imovine javnog preduzeća može da zabrinjava investitore, prema tome bilo bi dobro došlo, kaže, da se poboljšava vrednost PTK-a, da se poboljšava. Da vlada razmatra mogućnost rešavanja budućeg statusa društvene imovine nakon privatizacije javnog preduzeća, Vlada krši svoje pravo i svoje obaveze, svoje zakonsko pravo. Zašto ovo kažem? Jer Vladi se žuri da privatizuje asete, da ima 25%, da investitor preuzme sa ugovorom i da radnici izgube svoje pravo i da se čeka godinama da se to pravo ostvari, jer sledeći investitor moraće ovo da poštuje. Ja apelujem ovde na ministre, na gospodu poslanike, na sve nas ovde da dobro analiziramo i da dobro, ako je jedna institucija javno preduzeće profitabilno, ako je na tržištu, može samo sebe da pokrije, da se malo ponašamo ekonomski i razvojno kada je u pitanju ovo pitanje. Kada analiziramo situaciju u PTK-a vidimo da stvarno 45 hiljada zarađuje po jednom zapošljenom, dok je u regiji, ostale regije zarađuju do 140 hiljada, kao što su Slovenija, Hrvatska i Srbija 85 hiljada, što znači da je ipak profitabilna. Mi znamo da je Kosovo na zadnjoj lestvici i s time moramo da se pomirimo. Ja ću jedno samo da kažem, mi smo do sada imali privatizaciju društvenih preduzeća, šta smo zaradili? Jedan fond od pola miliona, a danas da ustanemo da gradimo jednu fabriku, je milijarda, milijarda i po. Mi smo sve privatizovali so sniženoj ceni, a sada šta radimo. Ja ću to da kažem na albanskom, do sada je bilo - malli në zbritje, a sad će biti - malli në likuidim. Molim vas, apelujem da dobro, dobro pazimo, da me građani slušaju da sam se ja ovde kao poslanica od ovog izveštaja, koji smo analizirali i kao grupa i stav grupe je da se ekonomski razvoj ozvaničava tako da se na socijalni program, šta znači

socijalni program, svaki zaposleni za otkup godine po stažu, da se napravi cena godine staža. Znamo u regiji, kad su se prodavali asetii od 20%, u regiji je prodato samo 20%, a ne otuđeno 75%. Apelujem, pošta ima negde oko 11 hiljada radnika, ima raseljenih radnika 2 - 3 hiljade, nisam u toku koliko i ostalih zajednica, tako da se ovim putem krše i prava i slobode zajednica.

Jako mi je žao, juče, što moram da podignem ovo pitanje, kada je bio Bord Agencije za privatizaciju, gde se prestrajavaju ljudi, kao što su u bordu za PTK-a, kada je u pitanju gospodin Slobodan Petrović, moram da kažem, gde se prestrajavaju ponovo u Agenciji za privatizaciju i gde ova vlada samo radi pojedine službenike copy – paste, ja ovo više neću da odobravam, čutanje odobravanje, ja ću da podignem ovo pitanje i ne može niko od nas da ima 5, 6 i 10 funkcija. Molim vas da se jako dobro domaćinski ponašamo kada su ovi asetii, da ima dekapitulizacija preduzeća javnih, da pokušamo sa tim, pred nama su tehnička pitanja, a jedno od tehničkih pitanja, moram da dam doznajanja, biće i to što će Ministarstvo Srbije i Kosova sravnjavati međusobne poverilačko - dužničke odnose. Apelujem da ovo pitanje ostavi i da se reši sa zajedničkim naporima svih nas. Hvala!

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Eqrem Kryeziu, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Tani, unë do të kërkoja numrin e deputetëve të nevojshëm për t'u zhvilluar debati, për të vazhduar debati. A kemi numrin e nevojshëm për të vazhduar debatin?

Janë këtu sa janë, në fakt, mirëpo Rregullorja e lejuaka që të shkohet më tutje. Prandaj, po ju kumtoj listën e oratorëve deputetë: Fatmir Rexhepi, Bajram Kosumi, s'është këtu, Donika Kadaj, s'është këtu, Shkëmbini, s'është këtu, Berim Ramos, mund të jetë këtu, Ismail Kurteshi, Kaqusha Jashari, Riza Smaka dhe Abdyl Ymeri. E ka fjalën zoti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues i kësaj mbledhjeje të Kuvendit!

Përshëndetje, Kabinet qeveritarë!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më shqetëson fakti për rëndësinë e madhe që ka strategjia e ofruar nga Qeveria për një projekt nacional, perspektivën e zhvillimit, impaktit që ka në jetën ekonomike të vetë kompanisë, por edhe ajo që reflekton kjo më vonë në zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit të telekomunikacionit në vend. Mos prania, them, e njerëzve përgjegjës këtu në Parlament, sigurisht që e zvogëlon peshën edhe të fjalës, edhe të debatit, qoftë mungesa e kryetarit të Parlamentit, e kryeministrit, një pjese tjetër të Kabinetit, që janë në Komitetin drejtues që na e kanë ofruar këtë projekt strategji dhe të deputetëve që mendoj që ka qenë koha të jemi të pranishëm këtu, të kontribuojmë ashtu qysh e kërkon momenti. Po, sido që të jetë, unë do të përpiqem ta them mendimin tim politikë lidhur me këtë projekt, duke qenë njëri nga deputetët që jam angazhuar shumë në komisionin parlamentar në debatet që i kemi pasur bashkërisht me ministrinë dhe kemi pas mundësinë pra që ta analizojmë, vlerësojmë, të japim opinionet qoftë për planin kohor, qoftë për modalitetin e ofruar, qoftë për dinamikën, për vërejtjet parimore dhe çështje të tjera.

Unë, personalisht kam përcjell mendimin tim edhe në grupin parlamentar dhe mendoj që të jem përkrahës i fortë i asaj politike programe të LDK-së e cila është e përcaktuar për ekonomi të tregut, atë politikë të LDK-së e cila po ashtu shtron kërkesat për një menaxhim më të mirë të këtyre ndërmarrjeve publike, e që besa vlerësuar nga 10 vitet e kaluara, asnjëherë nuk e kemi kaluar testin sa i përket një menaxhimi të tillë, çka edhe ka reflektuar me vlerësime dhe qëndrime të cilat i njeh opinioni, e fatkeqësisht, as si Qeveri, as në këtë mandat, por as në mandatet e kaluara mendoj se sa i përket qeverisjes së ndërmarrjeve publike nuk e kemi kaluar testin nga ana ekonomike për të krijuar atë çka është pritur në ato ndërmarrje publike.

Unë përkrah, në parim, politikën edhe të LDK-së, edhe të koalicionit qeveritar lidhur me strategjitë që ofrohen për privatizimin e ndërmarrjeve publike. Aty ku kërkohet reforma që të jetë pjesë e zhvillimit edhe të ndërmarrjeve publike, duhet pa tjetër të jetë i pranishëm partneriteti publiko-privatë në qoftë se duam të ecim përpara, në kundërtën, mendoj që do të kemi stagnim dhe do të kemi probleme të cilat pastaj do të prodhojnë efekte tjera që do të shkojnë në dëm të zhvillimit jo vetëm të kësaj kompanie, por edhe përgjithësisht mungesë të investimeve të huaja, mungesë pra të zhvillimit të këtij sektori dhe të ekonomisë përgjithësisht.

Shtrohet edhe pyetja tjetër sikur që i kemi pasur dilema tona rreth ambientit, atij ekonomik, dinamikës kohore, benifiteve që duhet t'i mbajë shteti ose t'i ketë shteti mbi këto asete. Pse, ku dhe si të shtetet pra një pjesë e pasurisë së këtyre ndërmarrjeve publike, çka edhe në kuadër të strategjisë së ofruar, por edhe të opinioneve tona për disa çështje nuk pajtohemi. Prandaj edhe është debati lidhur me strategjinë, prandaj janë edhe opinionet, argumentet, arsyet ekonomike dhe të tjerat të cilat na takon si deputetë me përvojë, me eksperiencë t'i ofrojmë dhe të gjejmë metodën dhe zgjidhjen më të mirë që duhet lidhur me këtë projekt, me këtë strategji dhe përgjegjësisht me zhvillimin e këtij sektori.

Unë mendoj që specifikat e vendit tonë dhe praktikat e vendeve tjera na japin mjaftë argumente që metoda dhe strategjia e propozuar për privatizim tek ne duhet të ndryshojë në vetë modalitetin e ofruar.

Është një mungesë që ka sjellë huti të madhe, pra, vlerësimi real i aseteve të kompanisë dhe një analizë ekonomike e cila nuk ka qenë e pranishme në masën e duhur që të mund të nxjerrim edhe përfundimin sa më objektiv dhe sa më real që kërkohet.

Po ashtu, mendoj që ka vend ende të kemi këtë transparencë gjatë gjithë procesit, që jemi zotuar edhe më herët dhe njoftimi i publikut qoftë prej Parlamentit, qoftë prej debateve të tjera që duhet lidhen me këtë projekt.

Është po ashtu një mungesë që e përcjell këtë, jo vetëm lidhur me këtë ndërmarrje publike dhe këtë strategji, por përgjithësisht kornizën ligjore dhe ajo që ka filluar më herët, nuk ka përfunduar kur është në pyetje ristrukturimi dhe transformimi i ndërmarrjeve, gjegjësisht që të kemi edhe në këtë kompani, por edhe në kompani tjera publike kemi pasur pra një balancë, një aset të qartë, një afarizëm të qartë që nuk ka ndodhur, që do t'i ndihmonte shumë këtij procesi dhe këtij modaliteti, të cilin sot e kemi para veti, për të nxjerrë pra qëndrime sa më objektive ekonomike dhe politike.

Është me rëndësi, po ashtu, të mendohet edhe pjesa tjetër e praktikave dhe modaliteteve sa i përket statusit, pjesëmarrjes në aksione qoftë shtetit, qoftë të punëtorëve, qoftë të grupeve të interesit dhe të tjera. Me një fjalë, unë parimisht e kam përkrahur strategjinë, prandaj nuk jam ai që mendoj që strategjia duhet që të gjitha fondet, mjetet të shkojnë vetëm në një projekt, sepse është thanë këtu, po unë si deputet ndaj mendimin tjetër, se atë që e kam kërkuar nga kryeministri që duhet ta kemi strategjinë për infrastrukturën, qoftë të magjistraleve, qoftë të projekteve tjera, të hekurudhës dhe të tjera, pra të kemi po ashtu, në mënyrë që investimet dhe të kemi një zhvillim harmonik edhe në infrastrukturë, edhe në ekonomi të vendit.

Prandaj, unë personalisht po i jap edhe 2 – 3 vërejtje parimore, që kanë të bëjë me modelin e propozuar. Unë mendoj që nuk duhet të pranohet propozimi që 75% të privatizohet në start, nuk duhet që me një afat kaq të shkurtë të kryhet i gjithë privatizimi. Unë mendoj që është një aritmetikë e gabuar e konsulentëve që përfaqësojnë grupe tjera të interesit lidhur me vlerësimet,

lidhur me hapat, me planin kohor dhe asetet. Prandaj, po ashtu nuk jam i mendimit që duhet të gjitha mjetet nga shitja të investohen vetëm në një projekt, në këtë rast që është ideja që ato të shkojnë në autostradë. Benifitet afatgjata duhet t'i mendojmë edhe në këtë strategji, prandaj unë mendoj që privatizimi i kësaj ndërmarrje duhet të shkojë në dy faza, faza e parë të fillojë në këtë vit, ndërsa faza e dytë, pra pjesa e aseteve të tjera duhet të mbetet për diku mbas vitit 2015 dhe atë mendoj që të mbetet hapur vlerësimi i përbashkët i kësaj se sa është përqindja e aseteve që duhet të privatizohen. Pra, unë mendoj që ajo duhet të sillet diku prej 51 deri 55%, sikur që pjesa tjetër prej 45 deri 49% të mbahet në pronësi të shtetit dhe të privatizohet më vonë, të shihet interesi që të bëhen aksionarë ata që duhet të bëhen, qoftë punëtorët, qoftë grupet tjera të interesit edhe të privatizohet një pjesë pas vitit tjetër dhe të shihet realisht që kjo kompani të kalojë në menaxhmentin privat, të jetë pra menaxhimi privat, kapitali privat, dhe të kemi një mundësi të re të zhvillimit të këtij sektori, që mendoj është me interes për vendin dhe është në pajtim të plotë me politikën që duhet të kemi pra, partneritetin privato-publik dhe ekonominë e tregut të pranishme edhe në kuadër të privatizimit të kësaj ndërmarrje.

Po ashtu, sa i përket fondit, pra mbetet i hapur, ky është mendimi imi që diku ndoshta 50 - 60% të shkojnë në projektin e ofruar të autostradës, ndërsa mjetet e tjera nga shitja e kësaj kompanie në të ardhmen të orientohen në projekte dhe programe tjera të investimeve, të cilat realisht do t'i bëjnë shumë veprimtari, zhvillim dhe ngritje të GDP-së së vendit në sektor të tjerë, të cilët kanë nevojë aq shumë për investime të huaja. Mendoj që strategjia pra, për mendimin tim, edhe për pak kohë qoftë gjatë ditës, qoftë gjatë javës, qoftë gjatë kësaj, të mbetet e hapur, sepse është me rëndësi të arrijmë një konsensus politik. Pra, po për strategjinë, me ato rekomandime të cilat mendojmë që duhet t'i harmonizojmë, qoftë si koalicion, qoftë me opozitën, sepse është me rëndësi jetike ky projekt nacional dhe sigurisht që ka për të pasur një impakt të madh në zhvillimin e vendit, në jetën ekonomike, në jetën politike e kështu me radhë.

Prandaj, unë mbetem i hapur që këto opsione që i thamë, t'i ofrojmë bashkërisht dhe të gjëmë konsensusin më të mirë, ashtu që realisht të jemi në drejtim të krijimit, të zhvillimit të këtij sektori, po pranisë së partneritetit privato-publik, por me një strategji e cila realisht do të mbrojë interesin tonë dhe benifitet e shtetit edhe në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rexhepi!

Në radhë është zoti Ismail Kurteshi, meqë zoti Ramosaj nuk është aktualisht këtu. Të bëhet gati Kaqusha Jashari.

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Përsëndetje për të gjithë!

Javët e fundit kam kërkuar nga ministri për Ekonomi dhe Financa, ai i Bujqësisë dhe nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale ta njoftojnë Kuvendin se cilat janë efektet e privatizimit në sferën e punësimit dhe të investimeve?

Nga përgjigjet e tyre del se askush nuk ka bërë ndonjë analizë të thellë të efekteve të privatizimit, shifrat e të punësuarave janë minore, për rritjen e prodhimtarisë as që mund të flitet, kurse ndërmarrjet prodhuese të dikurshme janë shndërruar në restorante dhe shitore. Kundër privatizimit në këtë moment dhe në këtë mënyrë janë të gjithë njohësit e mirë të efekteve të privatizimit, prandaj edhe unë në parim nuk jam kundër privatizimit, por jam kundër privatizimit në këtë moment, pa një analizë të thellë të efekteve të privatizimit dhe po ashtu jam kundër formës që është prezantuar në strategjinë e Qeverisë së Kosovës, ku parashihet që të privatizohen 75% të Postës dhe Qeverisë t'i mbeten vetëm 25%. Ju faleminderit!

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti deputet! Edhe njëherë Bajram Kosumi, nuk është këtu. Shkumbini nuk është këtu. Berimi nuk është këtu, zonja Kaqusha Jashari e ka fjalën, ndërkaq të bëhet gati zoti Riza Smaka.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Me strategji është theksuar qëllimi i privatizimit në fillimin e tij, ku po citoj, thuhet: “Qëllimi i Qeverisë është që nëpërmjet një procesi të pranueshëm dhe transparent ta tërheqë një partner të fortë strategjik, që do ta modernizojë kompaninë dhe përmirësojë cilësinë e shërbimeve të telekomunikacionit”.

Për këtë qëllim, ne të gjithë në Kuvend, me siguri, në qoftë se janë të gjithë të përgjegjshëm edhe kanë përgjegjësi për punën e vet, e sot po e shoh mungesën e tyre, kam menduar që do ta arrijmë një konsensus, se ky qëllim është për të mirën e vendit, e sidomos në qoftë se me këtë strategji e kemi të garantuar procesin si dhe politikat adekuate transparente dhe llogaridhënëse, të cilat sigurojnë rritjen ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm. Por, diçka po ndodhë, nuk e di, unë kam ndërmend t’i propozoj disa sugjerime për këtë strategji, të jetë ajo që garanton një privatizim. Të gjithë janë për ta privatizuar, por njerëzit e përgjegjshëm me siguri japin votën për atë që janë të sigurt që do të realizohet në këtë drejtim.

Prandaj, në këtë strategji Qeverisë i bëhet pyetja se a po garantohet privatizimi i suksesshëm? Këtë nuk e siguron me këtë strategji dhe unë mendoj që duhet të plotësohet. I kam disa propozime, vetëm disa e me siguri ka mundësi edhe ka nevojë për më shumë.

Në nenin 1, korniza ligjore ekzistuese siguron vetëm zgjidhjen bazike për fillimin e privatizimit të ndërmarrjeve publike, në Ligjin të ndërmarrjet publike Komisioni qeveritar për privatizimin dhe Komisioni drejtues ndërministror për partneritetin publiko-privat nuk është që siguron mbikëqyrja ndaj tyre as nuk është siguruar roli i Kuvendit. Këto dy trupa, janë më shumë trupa politike e jo profesionale. Prandaj, Ligji për ndërmarrje publike duhet të amendamentohet ose le të vendosë Kuvendi, duhet të nxjerrë një ligj për privatizim veç e veç, për secilën nga ndërmarrjet publike, ku do të përcaktohen politikat e qarta. Këtë e argumentoj me disa të dhëna nga strategjia. Në faqen 23, 24, në pjesën e metodave konstatohet se me legjislacionin ekzistues është paraparë vetëm shitja e aksioneve nëpërmjet procedurës së tenderit dhe është proceduar tabelori i prezantuar, tabelori i përqindjes të aksioneve për shitje pa argumentet bindëse. Është rekomanduar gjithashtu se PTK-ja duhet të shitet, ku është përfshirë edhe biznesi postar, me një obligim që investitori ose blerësi ta ndajë Postën me një subjekt të veçantë juridik edhe pas privatizimit me një mundësi eventuale, kjo nuk është obligative për kthimin e saj në pronësi shtetërore.

Ky rekomandim i Qeverisë nuk është i qartë dhe kërkon në këtë strategji të sqarohet. Në faqen 21, kërkohet shitja në fillim 2/3 e aksioneve dhe mos të ketë Qeveria të drejtën t’i bllokojë vendimet strategjike ose shitjen e PTK-së, në pako. Në strategjinë e propozuar janë dhënë shumë mundësi, çka do të thotë që politika e privatizimit nuk është e qartë. Kuvendit duhet t’i prezantohet politika e qartë. Me këtë strategji Qeveria nuk ka ndërtuar dhe është propozimi i dytë, këtë që e thashë politika të qarta, në lidhje edhe me ristrukturimin e strukturës pronësore të PTK-së. Kjo duhet të përcaktohet pas një studimi të kujdesshëm të tregut që duhet të mbështetet në vendimet qeveritare, cilat aksione të shiten në rundin e parë, cilat më vonë ose,

është propozimi të gjitha, duhet të sqarojmë pse edhe çmimet e aksioneve a janë sot më të lira a nesër më të larta? Mos po ndodhë që blerësi, investuesi i shet pastaj shumë më shumë se sa i kanë marrë prej shtetit tonë.

Prandaj, nuk është çudi që shtrohet pyetja se a është koha e duhur për privatizim në mungesën e këtyre informatave?

Nën 3. në bazë të strategjisë, Qeveria, kryesisht mbështetet në propozimin nga këshilltari i transaksionit, si për politikën ashtu edhe për procedurat, gjithashtu edhe për modelet. Unë mendoj se ndihma është e mirë dhe është pozitive nga ky këshilltar, ose këshilltarët, nuk e di sa janë, por për mbështetjen e Qeverisë dhe pozicionin e saj negociues, mirë është të ketë edhe përkrahjen e shoqërisë civile, opinionit të gjerë, e sidomos mbështetjen me konsensus të Kuvendit, por nga biseda ose hapja ku mungojnë deputetët, nuk jam e sigurt që kjo do të bëhet.

Nën 4, në strategji nuk ka politikë të qartë për përdorimin e Fondit nga privatizimi i PTK-së. Ky fond duhet të shërbejë vetëm për interes publik, qoftë në infrastrukturë apo në arsim ose në ndonjë projekt tjetër kapital e kurrësi për konsumin buxhetor. Kryeministri, në deklaratën sot, ka sqaruar se po planifikohet për projektin e autostradës, por tjetër është deklarata, tjetër është pjesa e strategjisë ku duhet të theksohet qartë ku investohet edhe sa duhet ta shesim aksionin?

Nën 5 dhe e fundit, rreth dinamikës së procesit të privatizimit, unë mendoj se nuk është reale kjo çka është në strategji. Mendoj që nuk është reale se deri me tani nuk është parë tjetër pos shprehja, vendosmëria për privatizim nga Qeveria, që unë e vlerësoj pozitive, por mungojnë argumentet bindëse për punë përgatitore, analizat, programi social e të tjera. Unë mendoj për shkak të mungesës së këtyre akteve parapërgatitore, ose në mungesën e transparencës, ndoshta ekzistojnë, por opinioni nuk din, e kem in shqetësimin e punëtorëve të PTK-së, shqetësimin e Sindikatës, sepse e kanë frikën për fatin e punëtorëve edhe pyetje a janë edhe ata pjesë e dialogut social apo jo edhe çka u premtohet atyre? Unë mendoj se në këtë strategji është dashur ta kemi edhe këtë pjesë për t'i informuar njerëzit në PTK. Këto janë 5 propozime dhe unë mendoj se kjo strategji, pa këto plotësime, nuk garanton privatizim të suksesshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Jashari! Tani e ka radhën zoti Riza Smaka, të bëhet gati zoti Abdyl Ymeri

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Zëvendëskryeministër, ministra,

Deputetë të respektuar,

Sa i përket privatizimit, do të theksoj këtë që në vitin 2000, Shoqata e Juristëve të Kosovës edhe Lidhja e Ekonomistëve të Kosovës, bashkë me një numër të ekspertëve, ndër ta edhe profesor Jolie Dikson, emër i njohur i Mbretërisë së Bashkuar, kanë pas konkluduar se privatizimi nuk do të duhej të aplikohet, por transformimi pronësor. Ju lutem, edhe do ta shkurttoj, natyrisht, se është jashtë kontestit, por lidhur me temën, makro-politikat e kanë pas spostuar zotëri Diksonin, i cili e ka edhe një libër autoritativ në këtë fushë edhe kanë dominuar politikën e UNMIK-ut, spin dhe spin-off, që kanë dështuar krejtësisht, katastrofalisht ato dy metoda janë treguar ineficiente edhe inadaptet për rrethanat edhe askush deri në ditën e sotme me rrjedhat edhe epilogët e privatizimeve nuk është i kënaqur, pos atyre të cilët kanë nxjerrë profite shumë benifituese, të majme. Ata janë uzurpatorë.

Pra, sa i përket eksperiencave të derisotme, ato janë jashtëzakonisht të dobëta. Edhe abuzime, edhe pakënaqësi, edhe kontratat nuk janë përfillur as nuk përfillen dot. Ju lutem, punëtorët të

cilët, deshëm s' deshëm, kanë të drejtë në bazë të punës të investuar më parë, ata janë të nëpërkëmbur, janë larguar sikur lekat dhe nuk është e rastit kjo që sindikatat shprehin indinjatë të fuqishme. Unë e kam lexuar një material që na e kanë dërguar dhe i kam dëgjuar komentet, besoni janë shumë bindës.

Deri sot, Posta, ju lutem, ka realizuar ekstra profite, jo në saje të punës, të dijës e të angazhimit, por pikërisht e kryesisht në saje të pozitës dominuese në treg. Edhe kushdo që ka punuar në Postë edhe që punon, është shumë i privilegjuar krahasuar me këndo tjetër që punon, pos Trustit të Pensioneve, që është abuziv, abinicio, e kështu me radhë ndonjë organizatë e ngjashme, do të thotë, kjo. Edhe mos të harrojmë se aty është një numër i madh i punëtorëve të cilët pa fije të dyshimit, në valën e parë të privatizimit do të shkonin në shtëpi edhe tash po e them flen, që natyrisht se do të ishte menjëherë edhe reaksioni, me bazë, pa bazë, nuk po hyjmë, pakënaqësi e madhe, se ekonomia e tregut nuk toleron pranime në bazë të partizanisë, që është partizan i kësaj partie apo i asaj apo që është i privilegjuar i këtij apo i atij, por ka rregulla.

Vërejtje do të kisha pasur edhe në kuotën e privatizimit në valën e parë. Do duhej të ishte e kundërta, zoti kryesues, bile së paku të shihej, po e zëmë, se si po rrjedh e mos të ndodh që qysh në fillim të zhvishet Qeveria, përkatësisht shteti.

Përfundimisht, me respekte, propozoj që ky dokument të shtyhet. Një, ja e marrim shembull pozitën. Unë supozoj që ekziston një dozë e pakënaqësisë edhe në këtë mënyrë, po e zëmë, se është disiplina edhe hierarkia partiake që më mirë mos të jenë të pranishëm edhe në mënyrë implicite ta kundërshtojnë se sa të jenë këtu edhe të ndodhin keqkuptime të caktuara me kreun e partisë, dy parti në këtë rast, të mëdha. Kjo është një. Edhe në qoftë se e aplikojmë këtë fushatë, hajde t'i thërrasim ata të votojnë, del një improvizim i pashijshëm edhe i pahijshëm, ju lutem, sforcohet disi, domethënë del apriori se nuk është, nuk do të ishte vendim serioz.

Unë do të kisha propozuar edhe më tutje që këtë dokument ta shtyjmë për vjeshtë, me kusht që t'ia japim Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, t'ia japim Universitetit, të organizojmë tryeza edhe debate publike dhe të bëjmë përmirësime të caktuara, definime e specifikime të qarta dhe të vendosim në mënyrë meritore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Smaka!

Fjalën tani e ka zoti Abdyl Ymeri, të bëhet gati zoti Branisllav Grbiq.

ABDYL YMERI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot para veti kemi në shqyrtim një dokument të rëndësishëm rreth të ardhmes së ndërmarrjes publike – PTK-së. Natyrisht se me të përmendur fjala privatizim, kudo mëton në diçka jo të mirë, sepse procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore nuk i ka përmbushur parametrat e dëshiruar nga të gjithë ne.

Pjesa me e madhe këtyre ndërmarrjeve të privatizuara deri me sot, nuk janë funksionale, kurse numri i punëtorëve në këto ndërmarrje është shumë më i vogël.

Nga ky proces të gjithë kemi pritur se do të kemi më shumë vende të punës, rritje më të madhe ekonomike, zbutje të varfërisë dhe të papunësisë, prandaj edhe për privatizimin e ndërmarrjeve publike, e në këtë rast të PTK-së, ka mendime dhe opinione nga më të ndryshme, që kanë

shprehur shqetësime, dilema dh paqartësi të shumta në opinionin publik se si do të rrjedhë procesi i privatizimit të këtyre ndërmarrjeve, se mos do ta kenë fatin e ndërmarrjeve shoqërore.

Në këtë drejtim, debati i sotëm në Kuvend rreth strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës për privatizimin e PTK-së do të qartësojë shumëçka. Kjo strategji në strukturën e saj përmban analizën e tërësishme dhe aspektet relevante të privatizimit, ekzaminimin dhe vlerësimin e kushteve të tregut, studimin e privatizimit dhe Telekomit në rajon, si dhe përcaktimin e periudhës kohore për ta implementuar strategjitë e ndryshme të privatizimit. Por, unë megjithatë mendoj se këtij procesi është dashur t'i paraprijë një debat i gjerë dhe transparent në mes të ekspertëve të ndryshëm të kësaj fushe, me punëtorët e PTK-së, sindikatat, shoqërinë civile, mediat, me qëllim që opinioni i gjerë publik të krijojë opinionin e tij dhe në këtë mënyrë do të hiqeshin të gjitha dilemat, shqetësimet edhe paqartësitë eventuale.

Në kuadër të kësaj shtrohen shumë pyetje në të cilat sigurisht se do të përgjigjet ministri i Ekonomisë dhe Financave. Së pari, a duhet që PTK të privatizohet në këtë kohë, kur dihet se kriza financiare në tregjet ndërkombëtare ende po vazhdon, a është bërë vlerësimi i aseteve të PTK-së dhe sa është ajo vlerë, a ka vlerë të caktuar nën të cilën nuk do të duhej të privatizohet PTK-ja dhe sa është ajo vlerë, a do të ruhet struktura dhe fuqia e punëtorëve të tanishëm në PTK dhe çka nëse jo? Për të gjithë ne, si shoqëri, është e kuptueshme se privatizimi është transformim i aseteve dhe funksioneve qeveritare në sektorin privat dhe të gjithë jemi për një ekonomi të liberalizuar, me treg të lirë dhe të hapur drejt një konkurrence të drejtë në treg. Prandaj, është e qartë se përfshirja e kapitalit privat në ndërmarrjet publike dhe në këtë rast, të PTK-së, është i domosdoshëm dhe i pashmangshëm.

Me qëllim të modernizimit të kompanisë, menaxhimit më të mirë, ofrimit të shërbimeve më cilësore, pastaj përmes investimeve, kompania do ta rrisë performancën e saj në përgjithësi.

Mirëpo, duhet shikuar me kujdes praktikat dhe përvojat e vendeve tjera me ekonominë në tranzicion se si ka shkuar dhe cila është forma më e mirë dhe më e lehtë e privatizimit, që në këtë strategji janë dhënë disa opsione. Prandaj, është mirë që e kemi një opsion të kombinuar, kur një pjesë e aksioneve të mbetet në sektorin publik deri në atë masë që të jetë e pranueshme për të dyja palët. Por, pa marrë parasysh se çfarë mënyre apo opsioni përdoret në këtë rast për privatizimin e PTK-së, duhet që mjetet apo

të hyrat nga privatizimi të kenë impakt të drejtpërdrejt në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit, ngritjen e mirëqenies dhe përmirësimin e kushteve të jetës së qytetarëve dhe kjo, në fakt, do ta arsyetonte më së miri pse është ndërmarrë një hap i tillë, kur të kihet parasysh se ky proces është i suksesshëm dhe praktikisht i kemi rezultatet evidente, atëherë vetë rezultatet e arritura do të tregonin se ky proces ishte i domosdoshëm, por në të njëjtën kohë edhe i pranueshëm për të gjithë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Tani e ka radhën zoti Branislav Grbiq, të bëhet gati zoti Zef Morina.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem se, predsedavajući!

Uvaženi zameniće,

Gospodo ministri,

Pred nama je Predlog strategije za privatizaciju Pošte i Telekomunikaciju Kosova. To je zaista jedan ozbiljan materijal koji zahteva jednu ozbiljnu analizu i ozbiljno vreme. Poslanička grupa za integracije je ukazivala kroz period učešća u institucijama Kosova, ustvari delimično tek sada, da ova tema traži jedne ozbiljne ljude i ozbiljni profil, ne samo Albanaca, nego kadrova srpske

zajednice. Mi imamo učešće predstavnika, ministra iz srpske zajednice, koji sigurno delom učestvuju i u procesu strategije privatizacije, znači ne samo KEK-a, nego i ostalih institucija Kosova, koje su od vitalne važnosti za građane Kosova. I ono što u ovom izveštaju vidimo, a i kroz period, vremenski period rada Skupštine, vidimo jedan nedostatak učešća predstavnika srpske zajednice u svim važnim dokumentima. Dali je to pitanje njihove nesposobnosti ili njihovog prisustva i dekora u institucijama Kosova, to zaista već poprma situaciju zanemarujuću i mi ovog puta želimo ne samo da razgovaramo o ovoj strategiji, koja je sigurno, biće podržana u smislu kao jedan važan dokument u naporima Vlade da ostvari što veći dobit za građane Kosova kroz jedan zaista pošten pristup privatizaciji, a ujedno da kažemo i da se zahvalimo i premijeru i Vladi na poverenju koje je ukazala predstavnicima srpske zajednice u institucijama Kosova.

Mi možemo da kažemo da po prvi put imamo zaista jedno učešće predstavnika Srba u institucijama, koje možemo reći da se graniči sa neograničenim poverenjem. To poverenje mislim da je dosta zloupotrebljeno i da nije adekvatno približeno svim predstavnicima koji su u ovoj skupštini i koji se nadaju i čekaju vreme kada će doći i ostvariti svoj neki interes. Imamo dva ministra koji ne znaju zašto uopšte služe Vladi i kome služe. Imamo ministra za rad i socijalu, koji uopšte ne zna socijalni program da iznese u ovom dokumentu, dali je to, znači radi se, dali je on spreman uopšte da prihvati takvu jednu odgovornost. Imamo jednog ministra za Povratak, koji gradi fantomske zgrade, 7 zgrade, 6 zgrade, gde Vlada troši enormna sredstva, a ne znamo listu korisnika. To su sve znači investicije koje trebaju se pokrivati iz ovakvih situacija privatizacije. Prema tome, mi tražimo i apelujemo da se predstavnici srpske zajednice u delu gde je njihova prisutnost moguća, a to je vrlo mali prostor, jer znamo da imamo samo dva ministra i da vrlo malo možemo da učestvujemo u Vladi, da zaista bude pokriveno sa odgovornim ljudima, sa ljudima koji su obrazovani, koji nemaju fantomske diplome, sa ljudima koji znaju posao i koji su uvek bili na odgovornim mestima. Znači mi želimo da ovoga puta na jedan indirektan način podržimo ovaj predlog privatizacije, da damo podršku ministru Financija i da ujedno damo i podršku Vladi i premijeru i da kažemo da ... grupa ima spremnost i kvalitete za ovakav jedan program i nastavak u institucijama Kosova. Hvala!

Drejtmin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë

Mund të them që nuk janë kushtet për të vazhduar debatin. Kjo është një çështje me rëndësi vërtet për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe duhet ta ndërpres debatin për t'i bërë thirrje edhe opozitës që të jetë pjesë e debatit. Një pauzë deri në orën 14:00. Pra, kërkoj që edhe një herë edhe opozita të jetë pjesë e seancës, por edhe pozita të ketë përgjegjësinë për të qenë prezent në sallë. Deri në orën 14:00 një pauzë. Edhe një herë i bëj ftesë publike opozitës përmes televizionit, që të jetë pjesë e debati në orën 14:00

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

Në sallë kemi 57 deputetë. Debatimi mund të vazhdohet, por vendim me këtë numër të deputetëve nuk mund të marrim. Tani 59 deputetë i kemi. Vazhdojmë me debatin.

Sipas radhës, deputeti Bajram Kosumi nuk është. Vazhdojmë.

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni- Kaloshi.

HYDAJET HYSENI- KALOSHI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që duke ju përshëndetur të theksoj që në fillim se kam një propozim të cilit, mendoj, i duhet, si të thuash, edhe një sqarim i qëndrimit tim dhe pa u frikësuar se mund të kuptohem keq, unë do të dëshiroja që edhe këtë propozim të Qeverisë ta përkrahja, ta përkrahim edhe bashkërisht. Kur është diçka që është në interes të shoqërisë, do të duhej të ishte edhe e mbështetur prej gjithë përfaqësuesve, pa dallim nga përfaqësimi politik.

Por ç' është e vërteta, në mënyrën si na ka ardhur strategjia, jemi vënë në pozitë të zorshme, po shprehem me një fjalor pak a shumë të humorit tonë, jemi vënë në opozitë të zorshme, të papërshtatshme dhe na duhet ajo lutja: - O Zot, më jep durim që të pajtohem me gjithçka që duhet pajtuar, por edhe për të kundërshtuar gjithçka që duhet kundërshtuar dhe më jep, si thotë, edhe mençuri për t'i dalluar këto, dhe ç' është e vërteta, për t'i dalluar këto, na duhet pak më shumë informacion, na duhet pak më shumë kohë. Aq më tepër kur këtu po përmenden nga pak edhe parametra vazhdimisht ideologjikë, që dikë edhe mund ta vënë në siklet. Ç' është e vërteta, unë nuk e kam këtë siklet dhe nuk e fsheh që jam në përcaktimet e mia - i majtë dhe nuk tutem tash se kjo do të më kushtoj shumë, por jo aq mëngjerash sa të kontestoj edhe atë që është nevojë e Kosovës, Ligjin e tregut, funksionimin e lirë të tregut dhe në këtë kuptim, natyrisht, jo edhe të kontestoj privatizimin, si të tillë. I duhet Kosovës iniciativa private, i duhet Kosovës edhe zhvillimi kapitalist i ekonomisë, sepse është dëshmuar gjithkund si i suksesshëm, pse jo edhe në Kosovë, sidomos në kontestin në të cilin ndodhet Kosova.

Por, megjithatë druaj se nganjëherë kjo floskula ideologjike po përdoret për të futur pastaj nën rrogos edhe atë që në fakt nuk është përfaqësimi i asaj që është përvoja më e përparuar e zhvillimit bashkëkohor kapitalist. Këtu janë edhe dilemat e mia.

Si të thuash, nuk jam kundër privatizimit si të tillë, por nuk do të thotë edhe që duhet përkrahur çdolloj privatizimi, në çdo kohë dhe gjithkund. Te ne po ndodh një fenomen, të privatizohet gjithçka deri edhe vetë procesi i privatizimit. Mendoj që duhet dalluar kush ta bëjë privatizimin, kur të bëhet privatizimi, sa të privatizohet, si të privatizohet edhe çka të privatizohet? Mua më ka rënë jo fort moti në Gjenevë, me drejtuesit e Gjenevës dhe ata na thoshin qartë, Gjeneva është shembull për ata që e dinë për zhvillim dhe përparim edhe në Zvicër, edhe me gjerë se privatizimi po, por disa sektorë nuk lejojnë kurrë të privatizohen: rryma, uji, hekurudhat, posta, thotë kurrë nuk do të lejojmë të privatizohen. Nuk di pse Kosova nuk duhet të shikojë edhe modele të tilla që janë dëshmuar si të suksesshme dhe jo të shkojnë prej një skajshmërie në skajshmërinë tjetër.

Shtrohet çështja, a duhet në vetë procesin e privatizimit të kishte më shumë transparencë, më shumë dritë, më shumë ekspertizë, më shumë debat, në mënyrë nëse është e drejtë, të binden qytetarët, të bindet opinioni. Unë jam i bindur se po të bindeshin se është në interesin e vendit, edhe ata që protestojnë, do të ishin bashkë me Qeverinë, edhe përfaqësuesit e zgjedhur të popullit do të ishin të gjithë unik.

A është momenti tash pikërisht për të privatizuar këto dhe a i ka krijuar Kosova të gjitha kushtet, a po respektohen specifikat e Kosovës? Pse bash kjo përqindje, ky model, a duhej edhe të studioheshin më shumë variantet e privatizimit edhe me ekspertizë ndërkombëtare për të parë cili është më i favorshmi, mos po na ndodhë që të japim të gatshmen për veresi, si thotë fjala e popullit. Megjithatë, nuk mund të mos theksoj edhe një fakt që tendenca për të shkuar në format më të skajshme të trajtimit të ekonomisë dhe të privatizimit, mendoj që po injorojmë faktin se

në trendet e zhvillimit aktual, financiar e ekonomik, po kontestohet seriozisht prirja e liberalizimit të skajshëm në ekonomi dhe financa. A duhet edhe ne të nxjerrim përfundimin nga kjo?

Mendoj që do të duhej të mos lejonim që të na ndodhte, që të presim pulën që bën vezë si thuhet, kurse kjo pula për të cilën po diskutojmë është tamam pulë e artë që nuk bën vezë, por bën dukat. Nëse është e vërtetë ajo që nuk qarkullon në opinion, edhe këtu u tha që Posta e Telekomit tash jep shumëfish më shumë në para fitim, se sa që do të mund të jepte në variantet tjera, atëherë pse të nxitohemi ta bëjmë? Nëse kjo është e vërtetë, atëherë është interes i Kosovës që të ruajmë më shumë nga kjo pasuri, por nëse është thënie e kundërt ajo që po thuhet se kjo do të fundoset, siç ka prirje për të vazhduar praktikën gjithçka, njëherë të rrënohet si aset dhe pastaj të shitet lirë, atëherë duhet të kemi kujdes edhe miqtë mos t'i fusim në një aventurë të tillë, sepse do t'u kushtonte edhe atyre. Nëse, ani është, se kanë llogari edhe me kushte të tilla t'i paguajnë për vite të tëra punëtorët edhe që nuk janë ndoshta të nevojshëm, atëherë të shikojmë mos është edhe ndonjë specifikë e Kosovës që e krijon mundësinë që të ketë profit dhe atë profit mundësisht ta ndajmë. Ne kemi respekt për miq dhe duhet të kemi respekt për miq, por me miqtë edhe duhet të sillemi miqësisht, po edhe të kërkojmë edhe prej atyre që të jenë miqësor edhe ndaj nesh se jemi popull i varfër, ekonomi e shkatërruar e sapodalë nga lufta dhe nuk do të ishte mirë që, si të thuash, siç e ka shprehur dikush vërtet edhe bash të na bëjnë ta tjerim fierin, ta bëjnë rrapitoll, se shtrohet puna çka do të mbetet pastaj për të ardhme, çka do të mbetet për të privatizuar. E nëse ndodhë, për shembull, nesër një situatë emergjente, si ndodhi në botë, çka do të kemi ne si aset rezervë?

Edhe nëse ka motive jashtë strategjike, për ne është interes të kemi partnerë strategjikë. Mendoj që do të duhej të sqaroheshin dhe do të duhej të racionalizoheshin, edhe nëse kemi të bëjmë ndonjëherë me miq, edhe mund t'u themi miq, miq, dajë, dajë, por mbulohu pak, të mos na ndodhë ajo që na ndodhi me Ferronikelin se edhe Ferronikelin e kemi pas privatizuar pak si shkel e shko. Ndonjëherë nga ata që tash e kontestojnë dhe atëherë e kontestonin ata që tash e shtyjnë këtë projekt. E kam të zorshme t'i kuptoj këto fizikultura. Prandaj edhe propozimi im është që Qeveria ka bërë mirë që e ka përgatitur strategjinë, dhe bën mirë që e prezanton, por do të ishte mirë që të krijohet më shumë hapësirë për ta shqyrtuar, për ta analizuar, për t'u konsultuar, për t'i konsultuar edhe ekspertët, kemi të tillë. Për të konsultuar edhe përvojat e vendeve tjera dhe mirëkuptim besoj do të ketë edhe nga partnerët tanë që pas një kohe, ta zëmë në seancën e shtatorit, ta shqyrtonim dhe ta miratonim, besoj në përbërje më të gjerë edhe besoj me një tablo pak më të sqaruar të asaj çka po bëjmë, ku po shkojmë dhe çka do të ndodhë nga kjo, që të mos votojmë vërtetë në mënyrë të verbër?

Është ndër ndërmarrjet e para që po i bëjmë si të thuash si shtet i pavarur dhe sovran, pas një njohje ndërkombëtare të legjitimitetit dhe legalitetit të vendimit historik të Kosovës, do të duhej edhe të dëshmonim se edhe vërtet ndjehemi si shtet dhe sillemi si shtet se ndjehemi të pavarur, edhe ndërtojmë politikat e pavarura.

Natyrisht, gjithmonë në kooperativitet me partnerët ndërkombëtarë, pa lejuar as servilizmat e skajshme, as konfrontimet absurde. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar ministri për Ekonomi dhe Financa, Ahmet Shala.

Po ju njoftoj, në seancë kemi 65 deputetë, plus 3 janë jashtë sallës, kemi tre deputetë shikues.

MINISTRI AHMET SHALA: Ju faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar,

I nderuar zoti kryeministër,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,

Vërtet është një debat i cili meriton vëmendjen e secilit dhe përgjegjësinë e secilit. Unë këtu po dua të flas në emër të Komitetit Ndërmintoror që Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të kompetencave të veta e ka emëruar për t'i analizuar të gjitha aspektet e pjesëmarrjes së sektorit privat në Postë-Telekomunikacionin e Kosovës dhe si të tillë e ka aprovuar në mënyrë unanime, të prezantuar në Qeveri dhe të përcjellë në Parlament më 22 qershor. Mua sinjerisht më vjen keq në qoftë se në Kuvend, që nga 22 qershori nuk kemi pasur mjaft hapësirë për ta debatuar këtë në grupe më të vogla apo më të mëdha për të sqaruar dhe kërkuar sqarime. Por, sot, kur ne kërkojmë në fakt që pas shumë, një muaj e më tepër pothuajse shtyrje, vërtet shtrohen shumë dilema. Strategjia ka të bëjë thjeshtë me dy-tri elemente, a duhet ta privatizojmë Postën apo jo, Postë-Telekomunikacionin e Kosovës. Të gjithë e thanë deri me tani, po dhe kjo është për të inkurajuar dhe i falënderoj të gjithë që në parim janë, po.

Cila është pika tjetër element me rëndësi për të ditur në strategji, sa për qind të aksioneve do të privatizohen? Komisioni Ndërmintoror, pas analizave të bëra dhe pas propozimeve të kështilltarit të transaksionit, ka ardhur deri te një përfundim se minimumi 75% i aksioneve do të duhej të privatizoheshin.

Arsyeshmëri ekonomike, nuk po flas këtu si ministër tani, por edhe si ekonomist më tepër, arsyeshmëri ekonomike për të mbajtur ekstra 25% nuk ka, sepse ai 25% në fakt nuk do t'i mundësojë ndonjë rezistencë të fuqishme kujtdo që të jetë pra, Qeverisë së Kosovës për të influencuar ndonjë vendim strategjik. Arsyeshmëria është thjeshtë politike që të mund të influencosh në disa nga aspektet, qofshin të punësimit, qofshin të strategjisë së investimeve dhe në kushtet specifike të Kosovës që ka sot, qofshin ato të pjekurisë politike e të njohurisë së gjithë elementeve makro-ekonomike, mbase arsyetohet dhe si të tillë, Komisioni Ndërmintoror unanimitisht e ka përkrahur.

Aspekt tjetër strategjik që është me rëndësi është çështja e punëtorëve dhe e mbrojtjes së të drejtës së tyre. Ka pasur propozime të ndryshme. Ne besojmë që 3 vjet deri në 4 vjet transfer i punëtorëve, natyrisht që do ta ulë pak a shumë ofertën e çmimit që do të ofrohet, por duke pasur parasysh kushtet specifike që i ka Kosova, neve do rrezikojmë një pjesë të hyrave, sepse imponimi i mbajtjes më gjatë të këtij numri të punëtorëve, që është i fryrë në fakt, nuk po hy në kualifikimet e kualitetit të tyre, mënyrën e punësimit e tjerë e tjerë, do të ndikojë në ofertën si të tillë. Por, neve kemi pranuar që ta bëjmë këtë dhe propozojmë dhe kërkojmë të na mbështesni.

Çështja e Postës është një element që, në fakt, e kemi trajtuar me hollësi dhe kemi ardhur në përfundim që pjesa e Postës, edhe pse tani për tani nuk është rentabile, do të mbahet si pronë e shtetit edhe pse në shumicën e rasteve, në fakt, përveç në Zvicër dhe në Gjermani, shumë vështirë të jetë rentabile. Por, duke pasur parasysh obligimin universal që ka një shtet t'u ofrojë shërbime postare qytetarëve të vet edhe në Bajgorë, edhe në Isniq, edhe në Kaçanik dhe në të gjitha skajshmëritë e vendi të vet, ne duhet ta mbajmë atë edhe pse besoj që me një menaxhim më të mirë, mbase mund të vijë deri te një pikë e rentabilitetit.

Unë dua t'ju jap se, u tha këtu mbase në mënyrë alegorike mjaft mirë, se nuk duhet ta shesim një pulë që bën ve, por më thoni që ajo vezë është për çdo ditë duke u zvogëluar, në fakt t'iu jap disa shifra, deputetë të nderuar.

Në vitin 2007, jo vetëm për shkak të fakteve, problemeve menaxheriale, por për konkurrencën që është në treg, mbulueshmëria e tregut, përkatësisht e aksioneve në treg, pra ndarjes së qytetarëve që kanë shërbime postare, nga 76% ka rënë në 62% dhe kjo është për t'u shqetësuar, ndërsa treguesi kryesor që është ..., që është fitimi para zbatimit të taksave dhe të amortizimit, ka rënë në mënyrë drastike, pothuaj se për 25% në vit, nga viti 2007. Po ashtu, të hyrat për njësi klienti kanë rënë prej 10,2 në 7,5 dhe ky trend i uljes së vlerës së Postë-Telekomunikacionit të Kosovës, dikush mund të thotë se kjo është një ulje e qëllimshme e tjera. Ju kisha lutur shumë, rezervohuni nga këto, se kurrkush nuk ka dëshirë që një aset që është shumë i rëndësishëm për popullatën e Kosovës, për buxhetin e Kosovës, të ketë ulje, por trendet në përgjithësi janë, nuk është vetëm në Kosovë kjo. Trendet në telekomunikacion në rënie dhe të gjitha shtetet tani në regjion janë duke vrapuar për të transferuar edhe ato pjesë të aksioneve të cilat i kanë.

Kemi fat, po them, ende kemi fat që shumica e partnerëve strategjikë në regjion janë të interesuar për të investuar në Kosovë dhe interesimi i tyre do të shpërndahet shumë shpejt në regjion, sepse edhe shtetet në regjion kanë ofruar goxha një ofertë joshëse, shumë më joshëse se sa te ne. Dhe frikohem që ofertuesit e fuqishëm në sektorin e telekomunikacionit mund të joshin më shumë në vendet e regjionit se sa ne, nuk është vetëm Posta e Telekomunikacioni i Kosovës që janë ofruar për shitje këto ditë ose që do të ofrohen këto ditë. Prandaj, do t'ju thirrja që ta votojmë në parim strategjinë, ndërsa neve do të jemi shumë të kujdesshëm, prapë si Grup ndërmintor t'i marrim parasysh disa nga aspektet që përmirësojnë...

Ne plotë mendime të mira dëgjuam sot, qoftë në aspektin e mbrojtjes së punëtorëve, qoftë në aspektet e tjera të dinamikës së privatizimit, në mënyrë që neve për vitin 2011 të kemi në buxhet mjaft para, përkatësisht të përfundojmë proceset këtë vit, të kemi mjaft para për t'i kryer edhe projektet tona jo vetëm ato të infrastrukturës, por edhe ato sociale.

Unë e kam thënë disa herë, edhe në media, janë vetëm dy-tri ligje të cilat kanë kosto deri në 38 milionë euro, të cilat duhet t'i mbulojmë diqysh, ose t'i rrisim taksat ose të shndërrojmë një aset në tjetrin dhe këto ose duhet të gjitha paratë pra të derdhen në buxhetin e Kosovës, se nuk mund të themi se kjo para, me këtë shifër, do të shkojë në autostradë, ndërsa kjo do të shkojë në këtë ligj, ose në këtë pension, ose në këtë veteran të luftës, ose për pagesën e saj. Pra, një thesar i vetëm është në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe këto mjete dedikohen për prioritetet e saj, sepse u ngritën shumë elemente se ku dhe si do të shkohet participimi i këtyre mjeteve për cilin projekt. Ne kemi projektet madhore nacionale, por kemi edhe projekte tjera sociale, të cilat konsideroj që janë benefi për të gjithë qytetarët e Kosovës, të gjithë, pa dallim.

Unë dua t'ju them se një agjendë që është paraqitur këtu, siguron në mënyrën më transparente të mundshme që ky proces i transferimit të asetëve të bëhet në kohën më të duhur të mundshme. Çdo vonesë, mos harroni, jemi vonuar në energji dhe tani po i shohim pasojat. Jemi vonuar në energji shumë dhe tani po i shohim pasojat.

Do t'ju kisha lutur, mos na lejoni dhe mos t'ia lejojmë asnjëri vetvetes që ta bëjmë edhe të njëjtin gabim, të mësojmë nga pësimet tona, është gabimi më i madh por megjithatë të pësojmë nga një gabim e mos të mësojmë nga dy gabime. Ndërsa, unë ju siguroj së bashku me Grupin ndërmintor se do të bëjmë gjithçka që është e mundur, që vërejtjet dhe sugjerimet tuaja, ato të cilat besojmë se do të shkojnë në kontribut, në përmirësimin e procesit të transparencës, të sigurimit të interesit nacional të Kosovës, do t'i zbatojmë me përpikëri.

Kaq desha të them për fillim dhe do të jem i gatshëm që të jap ndonjë sqarim apo përgjigje detale në çfarëdo elementi ose pike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit kryetar!

Unë kërkoj falje që po e marr fjalën, por e kisha lutur ministrin... Ne e kemi marrë në qershor këtë dhe e kemi lexuar, sepse po del që s'e kemi lexuar dhe gjithë këta që jemi këtu, jemi të interesuar si është më së miri të zhvillohet ky proces, e para.

E dyta, zoti ministër, më 19 korrik Komisioni e ka shqyrtuar dhe pikërisht për shkak të disa paqartësive s'kanë qenë në gjendje të dalin me rekomandim, zoti ministër. Po, vetëm e hedhim në Kuvend, ta debatojmë, e tjera, e tjera!

Prandaj, në këto gjëra, nga ai kujdesi që e kemi të gjithë, ne dëshirojmë në fund si të vijmë, si do të jetë e fundit sot, sepse ka shumë propozime, shumë diskutime, por që ka diçka edhe që dallon prej strategjisë. Duket që është pak, por kur vjen te përqindjet, kur vjen te modalitetet – janë ato paqartësi.

Prandaj, ne po e themi me përgjegjësi të plotë, pikërisht për shkak të seriozitetit që e llogarisim si grupe parlamentare, si deputetë – mendojmë dhe për këtë edhe jemi këtu, por kjo që ka ardhur deri sot këtu, mendoj se nuk është menaxhuar mirë. Ju e thoni “ka pas kohë mjaft për t'u debatuar”, e tjera, e tjera. Nuk qëndrojnë disa që i thoni, sepse po e them me përgjegjësi të plotë. Prandaj, për në fund, është fare e rëndësishme, zoti kryetar i Kuvendit, se si do ta bëjmë këtë. Do të ulemi, do të shohim cilat janë rekomandimet ose çka ky Kuvend si rekomandime dhe pastaj të shihet, se nëse e kemi vetëm qëllimin për të votuar, nuk është problem.

Unë konsideroj se sigurimi i numrit të pjesëmarrësve nuk duhet të brengosë Kuvendin tonë, por ta brengos përmbajtja dhe ajo – çka në fund, cilat do të jenë qëndrimet tona për këtë strategji dhe cilat do të jenë plotësimet eventuale. Kjo del shumë e përgjithësuar që: “votone në parim, e pastaj shohim dhe bëjmë...”! Kjo nuk shkon ashtu.

Pra, jemi këtu, jemi ndal të gjithë, me seriozitetin më të madh ta analizojmë mirë këtë dhe në fund ta kryejmë ashtu si dëshirojmë dhe që është më së miri për të gjitha ato që u thanë më herët, e që nuk dëshiroj t'i përsëris.

Dhe, po e përfundoj, komisioni nuk ka qenë në gjendje, sepse edhe këta llogarisin... e të mos e marr rolin e komisionit, por s'kanë qenë në gjendje të japin ndonjë rekomandim të qartë, përveç ta bien në Kuvend. Prandaj, nuk është bash e thjeshtë, sikur që u tha nga ana juaj. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri, e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Unë falënderoj shefat e grupeve parlamentare për pajtueshmërinë e tyre në parim dhe të gjithë deputetët për rekomandimet të cilat janë duke i dhënë, këshillat, por edhe vërejtjet.

Në këtë projekt nuk është duke u punuar sot për nesër, por është duke u punuar që një kohë të gjatë prej ekspertëve vendorë dhe atyre ndërkombëtarë me këshillat më të mira dhe për të ndihmuar se të gjithë mekanizmat relevantë ndërkombëtarë, në një proces gjithëpërfshirës, mund të them edhe gjithë diskutues në institucionet relevante dhe falënderoj edhe komisionin që e ka prezantuar dhe sjellë në Kuvendin e Kosovës, prandaj ajo çka sot kërkohet, është që të kemi një pajtueshmëri

parimore, në mënyrë që të gjitha rekomandimet të cilat janë dëgjuar sot, të inkorporohen në draftin përfundimtar dhe natyrisht se përsëri vendimi është i përbashkët.

Pra, ne jemi vetëm duke kërkuar rekomandimet e të gjithëve për të inkorporuar për të mirën e vendit, shtetit tonë.

Ndërsa, sa i përket të hyrave apo mjeteve, që u shtrua këtu çështja, përsëri Qeveria jep propozim dhe Kuvendi vendos se kah shkojnë dhe ku investohen ato mjete, në fund me miratimin e buxhetit. Faleminderit shumë!

Pra, sot kërkohet një pajtueshmëri parimore për t'u inkorporuar dhe vazhduar debatet që janë në proces me rekomandimet e Kuvendit dhe natyrisht të gjithë njerëzve vullnetmirë dhe profesionistë.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Ne po vazhdojmë me debatin. Kemi të lajmëruar 7 deputetë. Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër dhe ministra,

Sot shqyrtojmë Strategjinë për privatizimin e Postës. Nuk e shqyrtojmë parimin e privatizimit apo të mosprivatizimit dhe unë nuk jam e gatshme të votoj në parim për një dokument i cili, siç u diskutua edhe më përpara, ka shumë mangësi, duhet të plotësohet, duhet të studiohet mirë, duhet të analizohet dhe është kërkuar bile edhe një kohë bukur e gjatë për një studim dhe është kërkuar mendimi që kjo çështje të shtyhet edhe deri në shtator.

Nuk jemi kundër privatizimit dhe s'është hera e parë që po privatizohet ndërmarrja publike. Kemi të privatizuar një ndërmarrje publike, siç është Ferronikeli, prandaj mos të na hidhet hi syve të thuhet: "votoni në parim këtë dokument" se ky nuk është ligj që të votohet në parim, por është dokument dhe nëse votohet sot, atëherë veç e merr formën e dokumentit të këtij Parlamenti dhe i mbetet Qeverisë që ta ekzekutojë.

Prandaj, po them, si anëtare e një partie të qendrës së djathtë, që jemi të përcaktuar për parimin e ekonomisë së tregut, nuk jemi kundër privatizimit, por kundër këtij dokumenti që është sjell kësisoj. Duhet të plotësohet, duhet të përmirësohet, duhet të eliminohen mangësitë, e pastaj do ta votojmë këtë dokument.

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Hajdin Abazi e ka fjalën, le të përgatitet Zef Morina.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, i nderuar Kabinet qeveritar,

Unë i kam përcjellë me mjaft vëmendje debatet që po zhvillohen në Kuvend lidhur me strategjinë e privatizimit të PTK-së dhe të them të drejtën, pajtohem me një pjesë të kolegëve të cilët e ndajnë një shqetësim të arsyeshëm, por ajo që më brengos është se ne jemi këtu niveli më i lartë i përfaqësimit të qytetarëve dhe unë e vërej se është shprehur shumë dualizmi dhe sidomos vërehet ajo fryma që çdo gjë patjetër duhet të shfrytëzohet për qëllime politike, për të përfituar në opinion dhe jo për të shikuar interesin e vetë procesit ku jemi futur dhe ku jemi duke ecur.

Dhe, që ne të mund të ecim në drejtimin për të cilin jemi përcaktuar, ne na duhet një vizion i qartë dhe këtë vizion e ka shprehur këtu Qeveria, ne e kemi miratuar dhe do të bëhet privatizimi i ndërmarrjeve publike në Kosovë dhe se Qeveria, do të thotë, me miratimin tonë e ka përgjegjësinë për ta menaxhuar sa më mirë që është e mundur në këto rrethana.

Ne nuk duhet të harrojmë se kemi hyrë në një rend të ri dhe ky rend i ri kërkon ndryshime rrënjësore në të gjitha aspektet, në gjitha fushat, pra edhe në fushën e ekonomisë. Kjo do të thotë se ne, me të përcaktuar për këtë rend në të cilin jemi, kemi hyrë në një valle të cilën valle ne duhet ta bëjmë sipas ritmit që e ka ky rend i ri dhe jo të ndryshojmë apo të tentojmë ta ndryshojmë këtë ritëm, sepse do të dilnim anakronikë dhe nuk do të dilte asgjë në rregull. Pikërisht këtu unë shoh edhe një prej arsyeve për ta mbështetur këtë strategji të privatizimit të PTK-së, natyrisht me përmirësimet e mundshme të cilat na lejojnë.

Privatizimi në përgjithësi, edhe në këtë rast ky i PTK-së, është një provim që ne duhet ta japim, se vërtet jemi të vendosur për ta ndërtuar pa hezitim dhe pa mëdyshje rendin tonë të ri dhe ky rend i ri është një qeverisje e bazuar në ekonomi të tregut dhe jo në ekonomi shtetërore ose në ekonomi publike. Baza do të jetë pra ekonomia private dhe pastaj është tregu, konkurrenca, të cilat ne i rregullojmë përmes ligjit dhe ato që do ta thonë të ardhmen dhe procesin se si do të shkojë. Dhe, dihet se në vendet e perëndimit, sidomos ato që kanë instaluar demokracinë liberale, kërkohet sa më pak që qeveria të ketë mundësi për të ndikuar në ekonominë e vendit dhe, natyrisht, edhe ne duhet të inkorporohemi në këto rrjedha, prandaj ne duhet të japim të njëjtin provim me guxim dhe vendosmëri për të ecur përpara dhe jo për të hezituar dhe për të ndalë proceset përgjysmë.

Natyrisht, krejt kjo do të thotë se me rend të ri, ne kemi edhe një filozofi të re. Kjo filozofi e re nuk mund të funksionojë në konceptet e filozofisë së vjetër të sistemit të kaluar. Ne na duhen koncepte të reja, na duhet bindja e jonë se kemi të drejtë dhe duhet të ecim në këtë rrugë drejt me qëllim që vërtet edhe të kemi sukses.

Krejt ajo që është si shqetësim dhe ne na preokupon, është që të ketë transparencë më të madhe dhe ne sot dëgjuam zotin kryeministër, i cili premtoi se do të jetë transparenca shumë e madhe dhe madje do të jetë edhe live përmes emisioneve televizive ku do të shohim të tërë procesin.

Ajo që nga shumica këtu u shpreh si brengë, është se PTK-ja është rentabile. Është e vërtetë që është rentabile, por ne i dimë edhe disa mangësi që janë në PTK, të cilat i përmendi edhe zoti ministër, se ka një punësim enorm, ka paga të mëdha të cilat, me sa duket, do të shkojnë drejt një trendi që nga mbipesha e vetë do të bie, sepse nuk do të mund ta mbajë, prandaj unë konsideroj si vizion të Qeverisë që të ndërhyjë para se të ndodhë ajo, të paktën për t'i ruajtur vlerat e aseteve dhe ato të shiten me një çmim sa më të shtrenjtë të mundshëm.

Ajo çka mua personalisht në këtë rast më preokupon, është se si do të jetë fati i atyre punëtorëve të cilët do të mbeten pa punë, meqenëse ka të punësuar, thashë, në mënyrë enorme dhe kjo mund të prodhojë një problem social dhe Qeveria këtë duhet ta ketë parasysh dhe të ketë kujdes për të mos ndodhur kjo, do të thotë për të ruajtur disa të drejta, qoftë në përqindje, sikurse në rastet tjera të privatizimit, qoftë duke u siguruar të ardhura mujore për një periudhë të caktuar deri sa të akomodohen në vende të tjera të punës.

Thjeshtë, për mendimin tim, në këtë rend të ri që kemi hyrë, në këtë proces drejt konsolidimit të shtetit demokratik të bazuar në ekonominë e tregut, ne duhet ta paguajmë një çmim dhe këtë çmim ne e paguajmë për fat tumirë kësaj radhe për të mirën e Kosovës, për të mirën e qytetarëve, për të mirën e të ardhmes sonë. Nuk është çmim i lehtë, por është çmim që duhet të pajtohemi se duhet ta

paguajmë dhe të ecim sa më shpejt përpara që të realizojmë objektivat tona, me qëllim që ekonomia jonë të bëhet e fortë, të menaxhohet sipas parimeve të perëndimit dhe ne të arrijmë të krijojmë një të ardhme e cila do të jetë më e mirë dhe vërtet do të krijojmë kushte për një mirëqenie sociale.

Duke i pasur të gjitha këto parasysh, personalisht më duket pak si absurde kjo që ne jemi për privatizimin, por kur është rasti konkret, e kundërshtojmë privatizimin në një mënyrë ose në mënyrë tjetër.

Ne, është e drejtë që të kërkojmë përgjegjësi nga ministria ose nga ajo qendra ndërmministrare që e ka marrë përsipër ta bëjë këtë, të jetë sa më e kujdesshme dhe kjo e tëra të shkojë në dobi sa më të mirë të Qeverisë dhe të vendit, por jo të bëjmë bllokadë. Pikërisht për këtë, unë e them edhe publikisht, se unë do të votoj për këtë strategji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Qeveritë bëhen të përbashkëta për t'u interesuar për zhvillimin ekonomik të një vendi. Prandaj, nuk po e kuptoj qysh Qeveria mos të ketë ndërhyrje politike në ekonomi, kur ajo është e obliguar ta zhvillojë ekonomikisht një vend. Pra, harmonizoni pak fjalët! Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Zef Morina, pastaj Bujar Dugolli! Mirë, vazhdo Bujar, vazhdo! Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli!

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Po, në mes të asaj a të jam në këtë seancë apo mos të jam, unë megjithatë zgjedha që të jam këtu dhe të jap disa mendime të mia që ndoshta dikujt do t'i hynë në punë, ndoshta jo, por si do që të jetë, ta paraqes mendimin tim nga ai prizmi se si unë e shoh këtë.

Së pari, si deputet, që kam obligim karshi atyre votuesve të mi, konsideroj se nuk është mirë të sillemi në këtë formë si Kuvend, si organi më i lartë i vendit që të mos e jap opinionin e vet qoftë pozitiv, qoftë negativ karshi vendimeve të rëndësishme. Se, tek e fundit, qytetarët, punëtorët, të gjithë ata që preken nga ky proces, e dëshirojnë edhe mendimin qoftë pozitiv, qoftë negativ, por thjeshtë të jetë një transparencë e diskutimeve të këtyre proceseve.

Unë mendoj që komisioni funksional ka bërë një gabim të madh që nuk e ka shqyrtuar me kohë këtë dhe t'i paraqet rekomandimet nga aspekti profesional para Kuvendit, para deputetëve, që deputetët të mund të nxjerrin nga ky proces atë çka duhet dhe çka është shqetësim i qytetarëve. Komisioni është orientuar që të debatohet, të hapet debati dhe asgjë tjetër. Domethënë, kjo nuk është procedurë në rregull. Dhe, unë kam këtu vërejtje për çdo komision që i trajton këto çështje dhe i hedh në seancë pa kurrfarë përgatitjeje dhe ky nuk është seriozitet i punës dhe kështu vihet në lajthitje tërë institucioni për shkak se nuk kryhet puna si duhet. Tek e fundit, ne kemi pasur nevojë, ndoshta edhe komisioni, për trajtim serioz të këtij materiali me ekspertë të duhur dhe unë besoj se Qeveria këtë e ka bërë, sepse e ka sjellë, por duhet edhe Parlamenti ta kishte bërë dhe të shih realitetin ekzistues sa i përket kësaj çështjeje.

Nuk pajtohem me ata që thonë – procesi i privatizimit të ndërmarrjeve publike ka vazhduar edhe më herët dhe s'është diçka e re. Nuk është privatizuar asnjë ndërmarrje publike deri më tani, kjo është hera e parë që jemi futur... Privatizimi që ka ndodhur në kohën e UNMIK-ut, ka qenë privatizim i ndërmarrjeve shoqërore dhe çdoherë kam kërkuar të sqarohet se çka nënkupton

ndërmarrja shoqërore dhe publike dhe çdoherë ka pasur një qasje jo të duhur për ta klasifikuar... Sido që të jetë, gjatë procesit negociator këto ndërmarrje që konsiderohen të aseteve të vlefshme iu kanë transferuar në mbikëqyrje Qeverisë së Kosovës dhe Qeveria të vendosë për fatin e tyre.

Nga raporti që është sjell, konsideroj nga Qeveria dhe ekspertët e angazhuar, thjeshtë unë si deputet dhe besoj edhe tjerët që diskutuan e kanë një shqetësim për këtë ndërmarrje se a mund të vazhdojë në këtë gjendje apo duhet të ndërmerret diçka. Ajo tjetër është çka është folur në opinion, duke cilësuar këtë ndërmarrje shumë të rëndësishme dhe shumë fitimprurëse, ndërsa tjetër diçka na është afruar me shkrim nga niveli i ekspertëve. Dhe këtu mendoj duhet të ketë një qasje serioze të analizës.

Mendimi im është që ndoshta koha nuk ka qenë bash ideale, por edhe opinionin dhe të gjithë duhet ta dimë se ne jemi në një proces edhe politik dhe ekonomik bashkë me bashkësinë ndërkombëtare dhe unë duhet të jem i sqartë dhe real që cilado qeveri, cilido kryeministër të ishte, nuk do të mund t'i ikte këtij procesi, nga ajo përvojë që e kam dhe e di se si ka shkuar ky proces dhe si ka qenë e implikuar bashkësia ndërkombëtare.

Na vjen mirë kur komuniteti ndërkombëtar, miqtë i përkrahin procesin politik, të gjitha këto. Tek procesi ekonomik diqysh na duket rëndë kur kemi sugjerime, ndoshta të mira, por ndoshta edhe që mund të mos i pëlqejnë dikujt.

Unë si një deputet, mendoj që procesi ekonomik apo recesioni ekonomik në nivel global mund të ketë efekte negative në këtë dhe në vlerën që do të kishim pritur në gjatë këtij procesi. Është një fakt tjetër, mungesa e kodit të telefonisë, ka për të pasur implikime dhe këto implikime mendoj që Qeveria i di.

Mungesa e rregullativës ligjore për këtë çështje, për këtë ndërmarrje dhe ndërmarrjet që do të pasojnë, do të ketë implikime të veta, prandaj unë do të kisha kërkuar një kujdes të duhur që në rast se nuk ka mbështetje ligjore në disa fusha, më mirë është të pritët se sa të vazhdohet në formë të tillë.

Ju e dini se për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore kishin një obligim Kombet e Bashkuara dhe hartuan një rregullore që, në bazë të saj i privatizuan ato ndërmarrje dhe konteksti në aspektin ligjor ndërkombëtar më nuk mund të vjen në shprehje për shkak se ka një bazë. Dhe këtu dua të them që në rast se në gjitha fushat nuk ekziston baza e duhur, atëherë do të kisha kërkuar që të kihet kujdes në këtë aspekt.

Pronat e paluajtshme janë një çështje që janë hasur edhe nga ekspertët si një vështirësi dhe problem që mund të shfaqen gjatë procesit të privatizimit dhe pas këtij procesi.

Një diçka që më vjen shumë interesante, që nuk e kam parë askund dhe nuk u diskutua, është se ne kemi pasur një proces që është bërë nga bashkësia ndërkombëtare dhe janë hedhur disa praktika që tash, mirë a keq, Kosova i ka përfillur ato praktika. Dhe ato praktika janë metodat e privatizimit. Në këto metoda të privatizimit, unë mendoj kanë qenë disa praktika, sidomos për çështjen e punëtorëve, që konsideroj se nuk kanë qenë praktika të këqija sepse edhe te kjo ndërmarrje do të kemi problem dhe problemi veç vërehet nga reagimi i punëtorëve. Pse duhet të përjashtohet PTK-ja dhe punëtorët e PTK-ës nga 20%? Ose, nga 20% i pjesëmarrjes në asete, në aksione. Unë mendoj që edhe këtë çështje duhet ta shqyrtojë Komiteti drejtues ndërministror dhe duhet të japë një përgjigje. Kjo nuk është çështje që po bëhet një precedent vetëm me këtë ndërmarrje. Domethënë, kjo ka vazhduar prej 2003, një proces i tillë, dhe konsideroj që nuk është diçka

absurde edhe nëse mbesin 60% tek investitori i huaj, 20 te Qeveria, 20 tek punëtorët, po pa të drejtë tjetërsimi të atyre aseteve, si garanci që të jetë Qeveria e Kosovës dhe unë mendoj që do të fitojë Kosova dhe do të ecim përkrah këtij procesi, siç e kërkojnë edhe trendet ekonomike ndërkombëtare.

Unë mendoj se janë shumë çështje, pa u ndalur në detale për ta shqyrtuar këtë raport, që në disa raste është edhe kontraverz, sido që të jetë mendoj se Qeveria është e këtij vendi, është i këtij populli dhe i ka menduar këto seriozisht dhe mendoj se do të gjejë zgjidhje të mirë për t'iu dalë në përgjigje edhe qytetarëve, edhe punëtorëve dhe të mos bëjë hapa që mund të konsiderohen të gabueshëm.

Këtu, nga të gjithë ata që u dëgjuan, por edhe që kemi folur, nuk kundërshtohet procesi i privatizimit, por habitem se pse njerëzit nuk vijnë për t'i dhënë mendimet e tyre për këtë proces. E drejtë e secilit është që të votojë “për” ose “kundër”, por kontributi që mund të jepet në këto procese është shumë i rëndësishëm.

Unë i dhashë disa mendime, disa shqetësime të mia. Konsideroj dhe shpresoj se do të merren për bazë nga Komiteti drejtues, që të kemi një proces sa më transparent, sa më të mirë, që të përfitojë Kosova në këtë proces. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Zef Morina, le të përgatitet deputetja Edita Tahiri.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër, kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot kemi para veti një çështje shumë të rëndësishme, e cila deri më tani mendoj është hapi më i vështirë, të themi, që ne duhet të marrim.

Ne po bisedojmë për privatizimin e një kompanie, e cila është shumë profitabile. Mirëpo, nga aspekti tjetër, jemi në një situatë që vërtet ne dëshirojmë të jemi pjesë e Evropës dhe pavarësisht prej këtyre gjërave, ne duhet t'i hyjmë privatizimit, sepse në këtë mënyrë do të jemi vërtet të distancuar nga një sistem i vjetër që ka qenë gjer më sot. Por, shtrohet pyetja – a është bërë analizë e mjaftueshme për të ardhur deri te një hap i tillë?

Ne si komision, materialin nga Ministria e kemi marr para një muaji dhe pikërisht për këtë arsye komisioni nuk ka pasur mundësi ta shtjellojë dhe analizojë mirë, edhe pse në disa takime që i kemi pasur bashkë me ministrin, i kemi dhënë disa vërejtje apo disa sugjerime tona, të cilat është thënë se do të merren parasysh dhe për këtë arsye komisioni nuk ka mund të nxjerrë një vendim ose një rekomandim drejt Parlamentit, por kemi kërkuar që këtë çështje ta diskutojmë bashkërisht.

Është shumë e vërtet që hyrja e kapitalit të huaj do ta ndryshojë menaxhimin në një kompani çfarëdo qoftë, në këtë rast edhe në PTK. Unë nuk mendoj se menaxhimi është edhe aq i dobët, sa që ne duhet me çdo kusht ta privatizojmë, por është shumë e vërtetë që Kosova ka nevojë të ketë partnerë publikë privat, pra të jetë pjesë vetë, por të ketë edhe aksionarë të tjerë.

Praktikat e vendeve që kemi rreth nesh kanë treguar se ata të cilët me vëmendje dhe me një analizë të thuktë kanë bërë privatizimin, kanë pasur sukses. Të tjerët kanë pasur probleme, të cilat më vonë janë paraqitur dhe në njëfarë mënyre sigurisht ndoshta janë penduar për privatizimin që e kanë bërë.

Ne, nëse i shikojmë vendet që i kemi në region, me përjashtim të Shqipërisë dhe të Maqedonisë, asnjëra nuk ka dhënë më shumë se 50% , nuk i ka shitur aksionet. Shqipëria i ka shitur rreth 76, ndërsa Maqedonia 51%.

Në këtë rast, strategjia që është ofruar nga Qeveria, mendoj që duhet të shqyrtohet edhe një herë, sepse si vlerë e tillë prej 75%, është mendim i imi, është tepër. Është tepër, pikërisht në këtë fazë, sepse ndoshta do të kishte qenë shumë më mirë që të analizohet dhe të shkohet në etapa ose në faza të ndryshme, varësisht nga interesi ose varësisht nga momenti, e jo të shkohet menjëherë me këtë vlerë prej 75%.

Në këtë rast, ajo që më tepër na shqetëson të gjithë, besoj, është edhe analiza e cila nuk është paraqitur – sa do të jetë vlera e përafërt ose një vlerë nga ana e ekspertëve, e gjendjes momentale të PTK-së.

Në vitin 2004, kur PTK-ja kishte rreth 500.000 konsumatorë, është vlerësuar jo nga vendorët, por bashkërisht, edhe vendorët edhe ndërkombëtarët, që vlera e PTK-së të jetë rreth 1 miliard euro. Ne nuk kemi marrë ndonjë vlerë të analizuar nga ana e Ministrisë ose Qeverisë, por qysh kemi dëgjuar nga biseda, tani llogaritet rreth 600 milionë. Unë mendoj që kjo nuk është, do të thotë, vlerë e saktë, sepse numri i konsumatorëve është dyfishuar, PTK-ja – Vala në këtë rast, është zgjeruar më tepër. Prandaj, pavarësisht se vlerën e cakton tregu, që është shumë e vërtet, ne duhet ta kemi një vi të kuqe dhe në raport me përqindjen të cilën mendojmë ta privatizojmë, duhet ta dimë se sa do të jetë vlera e fundit, sepse nëse ne e lëmë kështu, atëherë kompanitë të cilat mund të konkurrojnë, qofshin 2, 3, 10 ose 20, mund të kenë një limit ose të kenë një marrëveshje që mos ta tejkalojnë atë, ose në njëfarë mënyre të bëjnë një pazar qysh ka ndodhur me kompanitë shoqërore.

Mendimi im, personal... Tash po flas, se edhe në Grup Parlamentar e kemi një qëndrim të njëjtë, është që të mos tejkalohet, pra të mos shitet më shumë se 51% në fazën e parë. Janë dy arsye: Arsyja e parë është sepse shteti ose Qeveria do të ketë një zë shumë më të fuqishëm në këtë kompani, do të ketë mundësi të thotë fjalën e vet qoftë në menaxhim, qoftë në zhvillim, qoftë në çdo aspekt tjetër që ka të bëjë me çështjet ekonomike. Dhe, e dyta, nëse eventualisht kompania e cila ose partneri i cili e blen, tenton ta shesë, a do të jemi ne në gjendje që prapë ta kthejmë këtë kompani qoftë përmes partnerëve tanë privat, që do të ketë në Kosovë, sigurisht në të ardhmen, njerëz që do të kenë interes të blejnë qoftë 10%, qoftë 15%, qoftë 20%. Kështu që, padyshim se unë jam për ta privatizuar, sepse kjo kishte për të dhënë rezultate shumë më të mira, por mos të ngutemi, sepse vlera e privatizimit është shumë e lartë.

Ne e kemi diskutuar edhe në komision. Mungesa e kodit telefonik do të ndikojë, e unë nuk mund të them sa, por me siguri për një përqindje të mjaftueshme dhe do ta ulë koston e PTK-së. Tash kam shpresë që pas njohjeve që do të vijnë në IT-u mjafton 50% plus një shtet dhe ne do ta fitojmë kodin, pavarësisht a jemi a s'jemi pjesë – anëtare e OKB-së. Prandaj, ndoshta edhe në këtë drejtim, nëse ne do ta kemi një kohë pak më të gjatë për analizim dhe shqyrtim, do të kemi mundësi që t'ia rrisim vlerën. Në këtë drejtim unë dëshiroj të them se jam për privatizimin, por sinqerisht kishte qenë mirë të analizohet pak më mirë, sidomos koha dhe vlera e përqindjes që është dhënë në strategji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Edita Tahiri, le të përgatitet diskutuesja e fundit, deputetja Sanije Aliaj.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,

Do të diskutoj si deputete dhe më lejoni të them që tema e privatizimit në përgjithësi, por në këtë rast edhe strategjia e privatizimit të PTK-së, janë çështje të cilat, sipas mendimit tim, duhet trajtuar në dy nivele.

E para, është niveli konceptual. Është vendimi ynë si Parlament, si Qeveri por edhe si qytetarë të Kosovës për të bërë një shtet demokratik, të ekonomisë së tregut, shtet të mundësive të barabarta e shtet ligjor dhe në kuadër të kësaj edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës e definon qartë orientimin tonë për ekonominë e tregut. Prandaj, privatizimi padyshim është një dimension esencial i konceptit të ekonomisë së tregut dhe në këtë kuadër, më lejoni t'ju them se mendimet që shprehin inercione nga sistemet e kaluara nuk e ndihmojnë reformën e madhe në të cilën ka hyrë Qeveria e Kosovës, në kuptimin e demokratizimit të vendit dhe të krijimit të parimeve të konkurrencës së lirë brenda ligjshmërisë së ekonomisë së tregut.

E dyta, mendoj se Kosova ka humbur shumë kohë për shkak të historikut të saj të rëndë dhe është ndoshta vendi i vetëm në rajon ku tranzicioni ka zgjatur mbi 20 vjet, prandaj është koha ta zëmë momentin. Nuk mund të krahasohemi me politikat e privatizimeve të vendeve të rajonit, sepse ata shumë më herët kanë kryer punën e shtetit dhe punët e zhvillimeve shtetërore. Prandaj, ne si një vend që u vonuam në këtë proces, tani duhet ta kompensojmë atë me politika vizionare, por edhe me shpejtësi në veprim.

Në këtë kontekst shoh edhe strategjinë e Qeverisë së Kosovës për privatizimin e PTK-së dhe unë mendoj që kjo strategji, e para, është bërë nga grup ndërmintor që reflekton edhe bashkëpunimin e koalicionit; e dyta, ka përfshirë komponentën e konsulencës ndërkombëtare që, për mendimin tim, është e domosdoshme për të zhvilluar një strategji të qëndrueshme dhe, e tretë, me këtë rast nuk ndodh privatizimi i plotë por, sikur figuron një strategji, një pjesëmarrje pra me 25%, që tregon se megjithatë ka një qasje vizionare në kuptimin e asaj që të ketë një rol në aksione edhe shteti ynë.

Në anën tjetër, privatizimi për mendimin tim, në këtë rast i PTK-së, duhet të ndërlihet me nevojat e shtetit tonë për investime kapitale dhe infrastrukturore.

Një vend që ka buxhet të limituar, nuk mund të mendojë të bëjë investime kapitale nëse nuk i ka ato mjete. Prandaj, në këtë kontekst duhet kërkuar të gjitha alternativat në mënyrë që të krijohen mundësitë për të bërë investime dhe ne të gjithë po e dimë se pa i vendosur në vendin tonë infrastrukturën qoftë rrugore, qoftë energjetike nuk kemi mundësi të zhvillojmë procese të cilat do të shpijnë në një ekonomi më të madhe dhe një zgjidhje për çështjen e papunësisë.

Prandaj, në këtë kontekst, në emër të Alternativës Demokratike të Kosovës ne mbështesim, në parim, këtë strategji dhe kërkojmë nga Qeveria që disa shqetësime të cilat u ngritën me këtë rast dhe në këtë kontekst dua të përmend çështjen e punëtorëve që është shqetësim i bazuar, por edhe disa shqetësime të tjera apo mund të them disa ide kreative që dolën sot, mund të përfshihen në strategji. Mirëpo, për mendimin tim, nuk duhet të udhëhiqemi nga mentaliteti i vonës, sepse kemi humbur shumë kohë. Koha është që të ecim përpara. Ju faleminderit!

KRYETARI: Unë e kam paralajmëruar diskutuesen e fundit dhe mësoni të lajmëroheni me kohë, e këta që lajmërohen tash e tutje, nuk e marrin fjalën.
Fjalën e ka deputetja Sanije Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra të pranishëm,

Të respektuar deputetë,

Unë, si deputete përkrah qëndrimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, i cili parim kryesor të punës së tij në Kuvendin e Kosovës e ka jetësimin e programit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, objektivin kryesor për një ekonomi të tregut të lirë. Mirëpo, unë si deputete, me këtë rast të shqyrtimit të strategjisë për privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës, shpreh këto shqetësime, në radhë të parë se kemi të bëjmë me një ndërmarrje publike që tentojmë ta privatizojmë për herë të parë.

Pse e them këtë shqetësim, sepse ne jemi dëshmitarë që 10 vjet që Agjencioni Kosovar për Privatizim në punën e vet...

KRYETARI: Regjia, i bini ziles!

SANIJE ALIAJ: ... për privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore ka dështuar po thuaj se plotësisht, sidomos me rastin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore me spin-off special.

Prandaj, edhe me këtë rast, shqetësimi im është se pse kaq në mënyrë të ngutshme është ofruar para Kuvendit, si institucioni më i lartë i shtetit, strategjia për privatizimin e Postë-Telekomunikacionit, pa i dhënë shans këtij dokumenti shumë të rëndësishëm për privatizimin e kompanisë shumë profitabile – Postës dhe Telekomunikacionit, pa u debatuar nëpër të gjitha grupet e interesit, pothuaj ashtu siç është vepruar me rastin e debatit që është bërë për Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pra, kemi të bëjmë me hapin e parë konkret të privatizimit të një resursi shumë profitabil për buxhetin e Republikës së Kosovës. Prandaj, çdo hap i ngutshëm, nuk është në interesin e shtetit të ri të Kosovës.

Arsyet pse e them këtë: Kolegë të nderuar, arsyeja e parë është se ende nuk e kemi siguruar infrastrukturën ligjore për privatizimin e kompanive publike. Pasuritë kombëtare me fanatizëm duhet të mbrohen, por edhe në qoftë se shkojmë drejt privatizimit të tyre, pa një infrastrukturë të mirëfilltë dhe pa përvojën e shteteve të rajonit, unë konsideroj që si Kuvend i Kosovës marrim përgjegjësi shumë të mëdha.

Arsyeja e dytë është, Posta dhe Telekomunikacioni asnjëherë nuk kanë qenë barrë për buxhetin e Republikës së Kosovës, kurse Elektroekonomia e Kosovës që 10 vite apo 11 vite të plota në mënyrë të vazhdueshme ka qenë barrë dhe nuk e marrim një hap konkret për ta hequr këtë barrë me privatizimin e kësaj kompanie shumë të madhe, por startojmë me Postë-Telekomunikacionin, një kompani e cila jo vetëm që e mban veten, jo vetëm që i mban punëtorët të cilët janë të punësuar aty, por edhe e furnizon me pjesën më të madhe buxhetin e Republikës së Kosovës.

Më tutje, ajo që mua më shqetëson, pse oferta për privatizimin e Postës dhe Telekomunikacionit është aq e lirë, kur pothuaj se kjo kompani publike i ofron buxhetit të Kosovës përafërsisht mjete buxhetore aq sa kushton i tërë privatizimi për 75%, ashtu si është e paraparë në strategji.

Dhe, me këtë rast kam edhe shqetësime të tjera. Pasi kemi të bëjmë me një dokumentacion shumë voluminoz, pasi kemi të bëjmë me një hap shumë të madh për interesin e Kosovës, propozoj që ky dokument dhe i tërë ky debat, me propozime konkrete nga ana e deputetëve, i tërë materiali, i tërë transkripti t'i ofrohet komisionit funksional dhe ai t'i ofrojë Kuvendit të Republikës së Kosovës rekomandime dhe ato rekomandime, së bashku me këtë dokument, në një të ardhme, pas pushimit

veror të debatohet kudo të jetë, me pjesën e opozitës këtu dhe të marrim hapa konkretë për një hap shumë të rëndësishëm me rastin e privatizimit të kësaj kompanie.

Pse e propozoj këtë? E propozoj, zoti kryetar, me një qëllim se asnjë dokument deri më tani, për çfarëdo interesi qoftë, nuk e kemi miratuar as debatuar pa rekomandime të komisionit funksional. Cili është interesi që këtë dokument ta ofrojmë për votim dhe të vihen dilema në deputetët e Kuvendit dhe t'i vëmë deputetët në sprovë para qëndrimit të grupeve parlamentare për t'u votuar apo mos votuar, kur kemi kohë dhe nuk kemi nevojë për ngutje për të marrë një hap shumë me interes për Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në sallë kemi 61 deputetë. Diskutues nuk kemi më të paraqitur. Tani janë 62 deputetë.

(Ndërhyrje)

Jo, dua ta qes në votim atë diskutimin e kryeministrit. Ju e keni grupin parlamentar dhe unë e qes vetëm në emër të grupit parlamentar, kërkesa nuk është në emër të grupit parlamentar. Megjithatë, na diskutimet që u bënë, edhe me propozimin e kryeministrit, ngarkohet Qeveria që vërejtjet dhe propozimet nga ky debat parimor të inkorporohen në dokumentin e strategjisë për privatizimin e Postës, në shtator i sillet Kuvendit, komisionet dhe Qeveria i bëjnë rekomandimet dhe ne do ta votojmë strategjinë me rekomandimet e komisionit. Sot votojmë, në parim.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Pa kartelë? 2 vota. Faleminderit!

Me 42 vota “për”, 4 “kundër”, 2 abstenime, miratohet në parim strategjia, për t'u rikthyer në shtator në Kuvend, për miratim.

E kemi edhe një pikë të rendit të ditës, që në fillim s'e kishim të renditur. Në pajtim me nenin 42 të Rregullores, Komisioni për Buxhet dhe Financa propozon një pikë shtesë, me pëlqimin e Kryesisë. Fjalën e ka deputeti Gani Koci, në emër të komisionit.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne, në seancat e kaluara kemi miratuar Ligjin për Bankën Qendrore dhe Kuvendi i ka përfunduar të gjitha procedurat dhe i është proceduar presidentit të Republikës së Kosovës për ratifikimin e ligjit ose për shpalljen e ligjit. Zyra ligjore e presidentit, gjatë shqyrtimit të ligjit të Kuvendit ka hasur në një dispozitë që është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ka propozuar që kjo dispozitë e ligjit të harmonizohet me përgjegjësitë që i ka presidenti në rastin e caktuar, sipas asaj që e jep Kushtetuta, neni 80 pika 17 më duket, neni 84, 27-tëshi, dhe Komisioni për Buxhet e Financa, në harmoni me kompetencën që e ka dhe kërkesën e presidentit, e ka rregulluar këtë dispozitë në këtë ligj dhe ia ka sjellë Kuvendit, për miratim.

Është fjala për dispozitën e nenit 41, paragrafi 3 dhe ne e kemi rregulluar këtë si komision, ndoshta në mënyrë pak më urgjente, sepse dje e kemi marrë këtë si kërkesë dhe Komisioni për Buxhet e Financa ia jep mbështetjen kësaj dhe kërkon nga Kuvendi që ta miratojë dhe t'i procedohet edhe njëherë presidentit, në procedurë të mëturjeshme.

KRYETARI: Në bazë të nenit 80, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi, me shumicë të votave të të gjithë deputetëve, numri i nevojshëm është 61 vota, për të vendosur për miratimin e Ligjit të rikthyer nga presidenti dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.

Pra, kërkohen 61 vota dhe kërkesa është konform Kushtetutës.

Do të thotë, ndryshohet neni 41, pjesa e fundit e fjalisë së parafundit, ku ka qenë: “vendimit të tij për aprovim nga presidenti, presidenti do t’i ketë 15 ditë pune për të vepruar, përndryshe vendimi i Kuvendit do të bëhet final”, duhet të jetë: “Presidenti mund ta aprovojë ose mos ta aprovojë propozimin e Kuvendit për shkarkim të guvernatorit apo të cilitdo anëtar të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës”. Kështu duhet të jetë.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Pa kartela? 2 vota.

Me 62 vota “për”, miratohet ndryshimi.

Faleminderit! Zoti kryeministër, mund ta merrni fjalën falënderuese tash për votimin, në parim!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Me këtë seancë, mbyllim sesionin pranveror të vitit 2010. Ju falënderoj për punën dhe ju dëshiroj pushim deri më 1 shtator. Mirupafshim në shtator!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës